



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-06/IA030

**Vendosi:** **Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit**  
Gjykatëse Mishelë Pikar  
Gjykatës Emilio Gati  
Gjykatëse Nina Jorgensen

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 31 maj 2024

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim mbi Apelet e Krasniqit dhe Selimit kundër Vendimit mbi Mocionin e  
Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarve**

---

**Zyrës së Prokurorit të Specializuar:**  
Kimbërli P. Uest

**Mbrojtjes së Hashim Thaçit:**  
Luka Mishetiq

**Mbrojtjes së Viktimave:**  
Sajmon Loz

**Mbrojtjes së Kadri Veselit:**  
Ben Emerson

**Mbrojtjes së Rexhep Selimit:**  
Xhefri Roberts

**Mbrojtjes së Jakup Krasniqit:**  
Venkatesvari Alagenda

**PANELI I DHOMËS SË GJYKATËS SË APELIT** të Dhomave të Specializuara të Kosovës (përkatësisht, “Paneli i Gjykatës së Apelit”, “Paneli i Apelit” ose “Paneli” dhe “Dhomat e Specializuara”,<sup>1</sup> bazuar në nenin 33(1)(c) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullën 169 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (“Rregullorja”), ka marrë në shqyrtim dy apele të dorëzuara më 12 janar 2024 nga z. Jakup Krasniqi (“Krasniqi”)<sup>2</sup> dhe z. Rexhep Selimi (“Selimi”)<sup>3</sup> (bashkërisht, “të akuzuarit” ose “Mbrojtja”) (përkatësisht, “Apeli i Krasniqit” dhe “Apeli i Selimit”, dhe bashkërisht, “Apelet”) kundër Vendimit mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarve (“Vendimi i Kundërshtuar”).<sup>4</sup> Më 25 janar 2024, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) u përgjigj se apelet duhet të rrëzoheshin (“Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së”).<sup>5</sup> Krasniqi dhe Selimi u kundërpërgjigjën më 2 shkurt 2024 (përkatësisht, “Kundërpërgjigjja e Krasniqit” dhe “Kundërpërgjigjja e Selimit”).<sup>6</sup>

---

<sup>1</sup> IA030/F00001, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, 21 dhjetor 2023, 21 dhjetor 2023.

<sup>2</sup> IA030/F00004, Apel i Mbrojtjes së Krasniqit kundër Vendimit mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarve, 12 janar 2024 (konfidencial) (“Apeli i Krasniqit”).

<sup>3</sup> IA030/F00005, Apel i Mbrojtjes së Selimit kundër Vendimit mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarve, 12 janar 2024 (“Apeli i Selimit”).

<sup>4</sup> F01917, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarve, 9 nëntor 2023 (“Vendimi i Kundërshtuar”). Më 22 dhjetor 2023, Paneli i Apelit zgjati afatet për dorëzimin e apeleve kundër Vendimit të Kundërshtuar dhe urdhëroi që këto apele të dorëzoheshin deri më 12 janar 2024. Shih IA030/F00003, Vendim mbi Kërkesën e Selimit dhe Krasniqit për Ndryshim të Afatit, 22 dhjetor 2023, para. 6. Shih gjithashtu IA030/F00002, Kërkesë e Mbrojtjes së Selimit dhe Krasniqit për Zgjatje të Afatit për Apelimin e Vendimit F01917, 21 dhjetor 2023.

<sup>5</sup> IA030/F00006, Përgjigje Përmbledhëse e Prokurorisë ndaj Apeleve të Mbrojtjes së Krasniqit dhe Selimit kundër Vendimit mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarve, 25 janar 2024 (konfidenciale) (“Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së”), para. 43.

<sup>6</sup> IA030/F00008, Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Krasniqit ndaj Përgjigjes Përmbledhëse të Prokurorisë ndaj Apeleve të Mbrojtjes së Krasniqit dhe Selimit kundër Vendimit mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarve, 2 shkurt 2024 (konfidenciale) (“Kundërpërgjigjja e Krasniqit”); IA030/F00007, Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Selimit ndaj Përgjigjes Përmbledhëse të Prokurorisë ndaj Apeleve të Mbrojtjes së Krasniqit dhe Selimit kundër Vendimit mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarve, 2 shkurt 2024 (“Kundërpërgjigjja e Selimit”).

## I. HISTORIKU

1. Më 8 mars 2023, ZPS-ja dorëzoi një kërkesë për pranimin si prova të transkripteve të intervistave dhe dëshmive të mëparshme të katër të bashkakuzuarve në çështjen gjyqësore KSC-BC-2020-06.<sup>7</sup>

2. Më 9 nëntor 2023, Trupi Gjykses lëshoi Vendimin e Kundërshtuar, ku, ndër të tjera, vendosi: (i) të pranonte si prova disa pjesë të caktuara të dëshmive të Krasniqit dhe Selimit të dhëna më parë si dëshmitarë para Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë ("TPNJ") dhe Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës ("PSRK"), si dhe provat materiale shoqëruese të tyre;<sup>8</sup> dhe (ii) se pranimi i transkripteve të intervistave dhe dëshmive të mëhershme të katër të akuzuarve si dhe i provave materiale shoqëruese, në vetvete, nuk është në dëm të të akuzuarit ose të

---

<sup>7</sup> F01351, Mocion i Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarve, 8 mars 2023. Shih gjithashtu F01473, Përgjigje e Mbrojtjes së Selimit ndaj Mocionit të ZPS-së për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarve, 24 prill 2023 (konfidenciale, e riklasifikuar si publike më 7 dhjetor 2023) ("Përgjigja e Selimit"); F01474/RED, Version i Redaktuar Publik i Përgjigjes së Thaçit ndaj Mocionit të Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarve, 24 nëntor 2023 (versioni konfidencial u dorëzua më 24 prill 2023); F01475/RED, Version i Redaktuar Publik i Përgjigjes së Mbrojtjes së Krasniqit ndaj Mocionit të Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarve, 15 nëntor 2023 (versioni konfidencial u dorëzua më 24 prill 2023) ("Përgjigja e Krasniqit"); F01476/RED, Version i Redaktuar Publik i Përgjigjes së Mbrojtjes së Veselit ndaj Mocionit të Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarve, 24 nëntor 2023 (versioni konfidencial u dorëzua më 24 prill 2023); F01509/RED, Version i Redaktuar Publik i Kundërpërgjigjes së Prokurorisë ndaj Përgjigjes së Krasniqit ndaj Mocionit të Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarve, KSC-BC-2020-06/F01509, 8 maj 2023, 11 korrik 2023 (versioni konfidencial u dorëzua më 8 maj 2023); F01510, Kundërpërgjigje e Prokurorisë ndaj Përgjigjes së Selimit ndaj Mocionit të Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarve, 8 maj 2023 (konfidenciale, riklasifikuar si publike më 9 nëntor 2023); F01511, Kundërpërgjigje e Prokurorisë ndaj Përgjigjes së Thaçit ndaj Mocionit të Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarve, 8 maj 2023 (konfidencial, riklasifikuar si publike më 9 nëntor 2023); F01512, Kundërpërgjigje e Prokurorisë ndaj Përgjigjes së Veselit ndaj Mocionit të Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarve, 8 maj 2023 (konfidenciale, riklasifikuar si publike më 9 nëntor 2023).

<sup>8</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 138-164, 187-207, 221. Në përputhje me Vendimin e Kundërshtuar, Zyra Administrative u caktoi numra prove materialeve të pranuar. Shih F02023, Memorandum në Përputhje me Vendimin mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarve, F01917, 19 dhjetor 2023 ("Memorandumi në Përputhje me Vendimin"). Shih gjithashtu Vendimin e Kundërshtuar, para. 221(d).

bashkakuzuarit dhe se nuk ka asnjë pengesë për pranimin e tyre kundër të bashkakuzuarve.<sup>9</sup>

3. Më 27 nëntor 2023, Krasniqi, Selimi dhe i akuzuari tjetër me ta, z. Kadri Veseli (“Veseli”), kërkuar leje për të apeluar Vendimin e Kundërshtuar.<sup>10</sup> Më 7 dhjetor 2023, ZPS-ja dorëzoi një përgjigje përmbledhëse,<sup>11</sup> dhe Krasniqi, Selimi dhe Veseli u kundërpërgjigjën me 15 dhjetor 2023.<sup>12</sup>

4. Më 19 dhjetor 2023, Trupi Gjykses dha leje për apelimin e katër pikave të mëposhtme nga 17 pikat për të cilat kishin kërkuar leje për apelim Krasniqi, Selimi dhe Veseli (bashkërisht, “pikat e autorizuarra për apelim”):<sup>13</sup>

- a. “Nëse Trupi Gjykses bëri gabim faktik dhe/ose juridik që konstatoi se pranimi i deklaratës së z. Krasniqi të majit 2007 dhënë si dëshmitar për TPNJ-në, i dëshmisë së shkurtit 2005 në procesin gjyqësor të TPNJ-së dhe i dëshmisë së majit 2007 për TPNJ-në (“provat e z. Krasniqi për TPNJ-në”), të cilat u dhanë në mungesë të informimit të tij për të drejtën për mosinkriminimin e vetes apo të garancive të tjera

---

<sup>9</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 215-219.

<sup>10</sup> F01961, *Kërkesë e Mbrojtjes së Krasniqit për Leje për Apelimin e Vendimit mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarve*, 27 nëntor 2023; F01966, *Kërkesë e Mbrojtjes së Selimit për Leje për Apelimin e Vendimit mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarve*, 27 nëntor 2023; F01964, *Kërkesë e Mbrojtjes së Veselit për Leje për Apelimin e Vendimit mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarve*, 27 nëntor 2023. Z. Hashim Thaçi (“Thaçi”) nuk kërkoj leje për të apeluar Vendimin e Kundërshtuar.

<sup>11</sup> F01990, *Përgjigje Përmbledhëse e Prokurorisë ndaj Kërkesave të Veselit, Selimit dhe Krasniqit për Leje për Apelim të Vendimit F01917*, 7 dhjetor 2023.

<sup>12</sup> F02010, *Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Krasniqit ndaj Përgjigjes Përmbledhëse të Prokurorisë ndaj Kërkesave të Veselit, Selimit dhe Krasniqit për Leje për Apelim të Vendimit F01917*, 15 dhjetor 2023; F02015, *Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Selimit ndaj Përgjigjes Përmbledhëse të Prokurorisë ndaj Kërkesave të Veselit, Selimit dhe Krasniqit për Leje për Apelim të Vendimit F01917*, 15 dhjetor 2023; F02009, *Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Veselit ndaj Përgjigjes Përmbledhëse të Prokurorisë ndaj Kërkesave të Veselit, Selimit dhe Krasniqit për Leje për Apelim të Vendimit F01917(F01990)*, 15 dhjetor 2023 (konfidenciale, riklasifikuar si publike më 26 janar 2024).

<sup>13</sup> F02022, *Vendim mbi Kërkesat e Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të të Akuzuarve*, 19 dhjetor 2023 (“Vendimi për Lejen për Apel”), para. 17-22, 27-32, 48-54, 73-77, 94(a). Trupi Gjykses vendosi të mos autorizonte apelimin e pikave të tjera për të cilat u kërkuar leja për apel.

mbrojtëse, nuk shkeli të drejtën e z. Krasniqi për mosinkriminimin e vetes ("Pika e Parë e Krasniqit");<sup>14</sup>

- b. Nëse Trupi Gjykses bëri gabim faktik dhe/ose juridik që konstatoi se z. Krasniqi nuk kishte të drejtën e garancive që i jepen personit të dyshuar në kohën e dhënies së provave për TPNJ-në, përfshirë të drejtën për t'u informuar për privilegjin kundër vetinkriminimit, të drejtën për mbrojtës dhe të drejtën për të heshtur ("Pika e Tretë e Krasniqit");<sup>15</sup>
- c. "Nëse Trupi Gjykses bëri gabim juridik që pranoi si prova deklaratat dhe dëshmitë e të bashkakuzuarve kundër z. Krasniqi dhe konstatoi se dëmi i shkaktuar nga pamundësia e z. Krasniqi për t'u bërë pyetje atyre në cilësinë e palës kundërshtare nuk zhbënte vlerën provuese të provave ("Pika e Nëntë e Krasniqit");<sup>16</sup> dhe
- d. "Nëse Trupi Gjykses gaboi që pranoi si prova deklaratat dhe dëshminë e z. Selimi të dhëna si dëshmitar në shkelje të të drejtave të mëpasshme të z. Selimi si person i akuzuar ("Pika e Tretë e Selimit")."<sup>17</sup>

## II. STANDARDI I SHQYRTIMIT

5. Paneli i Gjykatës së Apelit zbaton standardin e shqyrtimit për apelet e ndërmjetme të përcaktuar në vendimin e parë të tij dhe të zbatuar në vijim.<sup>18</sup>

---

<sup>14</sup> Vendimi për Lejen për Apel, para. 6.

<sup>15</sup> Vendimi për Lejen për Apel, para. 6.

<sup>16</sup> Vendimi për Lejen për Apel, para. 6.

<sup>17</sup> Vendimi për Lejen për Apel, para. 8.

<sup>18</sup> KSC-BC-2020-07, IA001/F00005, Vendim mbi Apelin e Hysni Gucatit për Çështje të Lidhura me Arrestimin dhe Mbajtjen e Tij në Paraburgim, 9 dhjetor 2020 ("Vendimi i Apelit të Gucatit"), para. 4-14. Shih gjithashtu p.sh. KSC-BC-2020-04, IA001/F00005, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Pjetër Shalës kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm, 20 gusht 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 20 gusht 2021), para. 5; KSC-BC-2020-04, IA006/F00007, Vendim mbi Apelin e Shalës kundër Vendimit në lidhje me Deklaratat e Mëparshme, 5 maj 2023 ("Vendimi i Apelit të Shalës"), para. 7.

6. Paneli rikujton se vendimet në lidhje me pranimin e provave trajtohen përgjithësisht si diskrecionale dhe se ndërhyrja e apelit në këtë aspekt përligjet vetëm në rrethana shumë të kufizuara.<sup>19</sup> Paneli gjykon se vendimi për pranimin apo mospranimin e provave në përputhje me rregullën 138(1) të Rregullores është, gjithashtu, vendim brenda diskrecionit të Trupit Gjykses kur bën vlerësimin e lidhjes me çështjen, autenticitetit dhe vlerës provuese të provave të paraqitura.<sup>20</sup> Në këtë aspekt, Paneli rikujton se nëse vendimi që kundërshtohet është vendim diskrecional, pala duhet të provojë se paneli i shkallës më të ulët ka kryer një gabim të dukshëm, në kuptimin që vendimi: (i) është bazuar në një interpretim të pasaktë të ligjit në fuqi; (ii) është bazuar në një përfundim faktik qartësisht të pasaktë; ose (iii) është kaq i padrejtë apo i paarsyeshëm saqë përbën shpërdorim të diskrecionit nga paneli i shkallës më të ulët.<sup>21</sup>

### III. PARASHTRIMET PUBLIKE

7. Paneli i Apelit vëren se Vendimi i Kundërshtuar dhe Vendimi për Lejen për Apel janë dorëzuar si publike, ndërsa një sërë parashtrimesh të apelit, konkretisht apeli i Krasniqit, Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së dhe Kundërpërgjigjja e Krasniqit, janë dorëzuar si konfidenciale.<sup>22</sup> Paneli rikujton se të gjitha parashtrimet e protokolluara para Dhomave të Specializuara duhet të jenë publike, përveçse kur ka

---

<sup>19</sup> Shih KSC-BC-2020-07, IA006/F00006, Vendim mbi Apelin e Nasim Haradinajt kundër Vendimit mbi Kërkesat e Prokurorisë lidhur me Dëshmitarët e Propozuar të Mbrojtjes, 7 janar 2022 ("Vendimi i Apelit të Haradinajt lidhur me Dëshmitarët e Mbrojtjes"), para. 14 dhe jurisprudencën e cituar në të.

<sup>20</sup> Shih Vendimin e Apelit të Haradinajt lidhur me Dëshmitarët e Mbrojtjes, para. 14; KSC-CA-2022-01, F00114, Aktgjykimin e Apelit, 2 shkurt 2023 ("Aktgjykimi i Apelit *Gucati dhe Haradinaj*"), para. 35, 93; KSC-CA-2023-02, F00038/RED, Versionin e Redaktuar Publik të Aktgjykimit të Apelit, 14 dhjetor 2023 (versioni konfidencial u dorëzua më 14 dhjetor 2023) ("Aktgjykimi i Apelit *Mustafa*"), para. 37.

<sup>21</sup> Vendimi i Apelit të Haradinajt lidhur me Dëshmitarët e Mbrojtjes, para. 14 dhe jurisprudenca e cituar në të; Aktgjykimi i Apelit *Gucati dhe Haradinaj*, para. 35, 93; Aktgjykimi i Apelit *Mustafa*, para. 36.

<sup>22</sup> Krasniqi bën të ditur se apeli i tij u dorëzua si konfidencial në bazë të rregullës 82(3) të Rregullores, pasi i referohet materialit konfidencial. Shih Apelin e Krasniqit, para. 6. ZPS-ja bën të ditur se përgjigjja e saj u dorëzua si konfidenciale në bazë të rregullës 82(4) të Rregullores, pasi i referohet apelit të Krasniqit. Shih Përgjigjen Përmbledhëse të ZPS-së, para. 42. Krasniqi gjithashtu bën të ditur se kundërpërgjigjja e tij u dorëzua si konfidenciale në bazë të rregullës 82(4) të Rregullores pasi Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së është konfidenciale. Shih Kundërpërgjigjen e Krasniqit, para. 3.

arsye të posaçme për t'i mbajtur konfidenciale, dhe se palët duhet të dorëzojnë për protokollim versione të redaktuara publike të të gjitha parashtrimeve që i paraqesin Panelit.<sup>23</sup> Paneli gjithashtu vëren se ZPS-ja dhe Krasniqi nuk kundërshtojnë riklasifikimin si publike të, përkatësisht, Përgjigjes Përmbledhëse të ZPS-së dhe Kundërpërgjigjes së Krasniqit.<sup>24</sup> Duke qenë se këto parashtrime nuk përmbajnë informacion konfidencial, Paneli rrjedhimisht konstaton se ato mund të riklasifikohen si publike. Sa i përket apelit të Krasniqit, Paneli urdhëron Krasniqin që të dorëzojë versionin e redaktuar publik të apelit të tij, ose të bëjë të ditur, me anë të një parashtrimi të protokolluar, nëse ai mund të riklasifikohet si publik brenda dhjetë ditësh nga marrja e njoftimit për këtë Vendim.

#### IV. DISKUTIM

8. Paneli i Apelit vëren se provat që janë objekt i apelit të Krasniqit janë: (i) dëshmia në TPNJ e dhënë në datat 29 deri 31 maj 2007 në çështjen gjyqësore *Haradinaj dhe të tjerët* ("dëshmia e majit 2007 në procesin gjyqësor të TPNJ-së");<sup>25</sup> (ii) deklarata për TPNJ-në e dhënë në datat 23 dhe 24 maj 2007 ("deklarata e majit 2007 si dëshmitar në TPNJ");<sup>26</sup> dhe (iii) dëshmia e dhënë në datat 10 deri 15 shkurt 2005 në TPNJ në çështjen gjyqësore *Limaj dhe të tjerët* ("dëshmia e shkurtit 2005 në procesin gjyqësor të TPNJ-së").<sup>27</sup> Paneli vëren se provat që janë objekt i apelit të Selimit janë:

---

<sup>23</sup> Shih p.sh. IA008/F00004/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Kadri Veselit kundër Vendimit të Rishikimit të Paraburgimit, 1 tetor 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 1 tetor 2021), para. 8. Shih gjithashtu KSC-CA-2022-01, F00103, Vendim mbi Kërkesën e Gucatit për Riklasifikim ose Versione të Redaktuara Publike të Vendimeve të Panelit të Gjykatës së Apelit, 9 janar 2023, para. 2.

<sup>24</sup> Përgjigja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 42; Kundërpërgjigja e Krasniqit, para. 3.

<sup>25</sup> P00800; P00801 (konfidencial); P00802.1-P00802.3; P00803.1-P00803.2; P00804.1-P00804.2; P00805.1-P00805.3; P008006.1-P00806.2. Prova materiale shoqëruese: P00810. Shih gjithashtu Vendimin e Kundërshtuar, para. 221(b), poshtëshënimin 633; Memorandumin në Përputhje me Vendimin, f. 6-7.

<sup>26</sup> P00793. Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 221(b), poshtëshënimin 633; Memorandumin në Përputhje me Vendimin, f. 6.

<sup>27</sup> P00794; P00795; P00796 (konfidencial); P00797.1-P00797.3; P00798.1-P00798.3; P00799.1-P00799.2. Provat materiale shoqëruese: P00807; P00808; P00809; P00293. Shih gjithashtu Vendimin e Kundërshtuar, para. 221(b), poshtëshënimin 633; Memorandumin në Përputhje me Vendimin, f. 6-7.

(i) intervista e tij për PSRK-në e datës 22 maj 2018;<sup>28</sup> (ii) dëshmia e datës 15 janar 2018 në procesin gjyqësor të PSRK-së;<sup>29</sup> (iii) intervista e datës 13 tetor 2016 dhënë PSRK-së;<sup>30</sup> (iv) intervista e datës 3 qershor 2013 dhënë PSRK-së;<sup>31</sup> (v) intervista e datës 27 shtator 2011 dhënë PSRK-së;<sup>32</sup> (vi) dëshmia e datave 27 deri 31 maj 2005 në procesin gjyqësor të TPNJ-së në çështjen *Limaj dhe të tjerët* ("dëshmia e majit 2005 në procesin gjyqësor të TPNJ-së");<sup>33</sup> dhe (vii) deklarata e 2 prillit 2004 për TPNJ-në.<sup>34</sup>

9. Paneli i Apelit do t'u referohet provave që janë objekt i Pikës së Parë të Krasniqit dhe Pikës së Tretë të Krasniqit si "provat Krasniqit për TPNJ-në". Paneli i Apelit do t'u referohet provave që janë objekt i Pikës së Tretë të Selimit si "provat Selimit për TPNJ-në dhe PSRK-në". Paneli i Apelit do t'u referohet provave që janë objekt i Pikës së Nëntë të Krasniqit në mënyrë më të përgjithshme si "deklaratat e të akuzuarve", pasi Krasniqi pretendon se pranimi prej Trupit Gjykues i të gjitha transkripteve të intervistave dhe dëshmive të mëhershme të të akuzuarve dhe i provave materiale shoqëruese kundër të bashkakuzuarit të tyre, cenonte të drejtat themelore të tij.

10. Fillimisht, Paneli i Apelit rikujton se provat e mbledhura në juridiksione gjyqësore të tjera mund të jenë të pranueshme në bazë të nenit 37(1) të Ligjit, ku përcaktohet si më poshtë:

---

<sup>28</sup> 1D00005\_ET (konfidencial). Shih gjithashtu Vendimin e Kundërshtuar, para. 221(b), poshtëshënimin 630; Memorandumin në Përputhje me Vendimin, f. 5.

<sup>29</sup> P00775\_ET. Shih gjithashtu Vendimin e Kundërshtuar, para. 221(b), poshtëshënimin 630; Memorandumin në Përputhje me Vendimin, f. 5.

<sup>30</sup> P00774\_ET (konfidencial). Shih gjithashtu Vendimin e Kundërshtuar, para. 221(b), poshtëshënimin 630; Memorandumin në Përputhje me Vendimin, f. 5.

<sup>31</sup> P00773 (konfidencial). Shih gjithashtu Vendimin e Kundërshtuar, para. 221(b), poshtëshënimin 630; Memorandumin në Përputhje me Vendimin, f. 5.

<sup>32</sup> P00772 (konfidencial). Shih gjithashtu Vendimin e Kundërshtuar, para. 221(b), poshtëshënimin 630; Memorandumin në Përputhje me Vendimin, f. 5.

<sup>33</sup> P00777; P00778; P00779; P00780; P00781.1-P00781.3; P00782. Provat materiale shoqëruese: P00783; P00784; P00785. Shih gjithashtu Vendimin e Kundërshtuar, para. 221(b), poshtëshënimet 630-631; Memorandumin në Përputhje me Vendimin, f. 5.

<sup>34</sup> P00776 (konfidencial). Shih gjithashtu Vendimin e Kundërshtuar, para. 221(b), poshtëshënimin 630; Memorandumin në Përputhje me Vendimin, f. 5.

Provat që janë mbledhur gjatë procedurave ose hetimeve penale brenda juridiksionit lëndor të Dhomave të Specializuara para themelimit të tyre nga ndonjë autoritet ose agjenci shtetërore ose ndërkombëtare për zbatimin e ligjit ose për zhvillimin e hetimeve penale, përfshirë Prokurorin e Shtetit të Kosovës, nga autoritetet policore në Kosovë, TPNJ-ja, EULEX Kosova ose nga TFHS-ja, mund të jenë të pranueshme para Dhomave të Specializuara. Pranueshmëria e tyre vendoset nga panelet e caktuara në pajtim me standardet ndërkombëtare për mbledhjen e provave dhe nenin 22 të Kushtetutës. Peshë qo do t'i jepet çdo prove të tillë përcaktohet nga panelet e caktuara.<sup>35</sup>

Sa i përket pranueshmërisë së provave, Paneli i Apelit gjithashtu rikujton në mënyrë të përgjithshme se në rregullën 138(1) dhe (2) të Rregullores, përcaktohet si më poshtë:

(1) Në rast se nuk janë kundërshtuar ose përjashtuar *proprio motu*, provat e paraqitura trupit gjykues pranohen vetëm në qoftë se kanë lidhje me lëndën, kanë vlerë provuese dhe vlera provuese e tyre nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre. Në rrethana të posaçme, në qoftë se trupi gjykues bindet se një aspekt nuk ishte i njohur në kohën e paraqitjes së provës, ky aspekt ngrihet menjëherë pasi bëhet i njohur.

(2) Provat e siguruara nëpërmjet një shkeljeje të Ligjit, ose të Rregullores, apo të normave të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, janë të papranueshme në qoftë se:

(a) shkelja hedh dyshim thelbësor mbi mbështetshmërinë e provës; ose

(b) pranimi i provës do të ishte shkelje, ose do të dëmtonte rëndë integritetin e procesit.

---

<sup>35</sup> Në nenin 37(3) të Ligjit, ndër të tjera, përcaktohet se:

Varësisht prej përcaktimit gjyqësor për pranueshmërinë dhe peshën e provave sipas paragrafëve 1 dhe 2,

a. transkriptet e dëshmimeve të dëshmitarëve të dhëna para TPNJ-së dhe procesverbalet e deklaratave të dëshmitarëve të bëra para TPNJ-së në pajtim me rregullën 71 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave të TPNJ-së, mund të jenë të pranueshme para Dhomave të Specializuara, me kusht që dëshmia ose deklaratat të kenë lidhje me një fakt që është objekt i shqyrtimit gjyqësor në procesin para Dhomave të Specializuara;

b. transkriptet e dëshmimeve të dëshmitarëve të dhëna para një gjykate në Kosovë, përfshirë dëshmitë e dhëna gjatë procedurës paraprake ose dëshmitë e ruajtura si pjesë e Mundësisë Hetimore të Veçantë sipas cilitdo kodi të procedurës penale të zbatueshëm në Kosovë në kohën përkatëse, mund të jenë të pranueshme para Dhomave të Specializuara, pavarësisht nëse e kanë dëgjuar apo jo gjykatësit që janë pjesë e panelit dëshminë fillestare; [...].

11. Siç është vërejtur saktë nga Trupi Gjykses, Ligji dhe Rregullorja “nuk rregullojnë shprehimisht aspektin e pranueshmërisë së deklaratave të të akuzuarit”.<sup>36</sup> Paneli i Apelit shton se as Ligji dhe as Rregullorja nuk rregullojnë shprehimisht aspektin e pranueshmërisë së deklaratave të një të akuzuari të dhëna *para një juridiksioni gjyqësor tjetër*. Gjatë trajtimit të këtyre aspekteve të ngritura në apele, Paneli i Apelit rikujton se neni 3(2) i Ligjit kërkon që Dhomat e Specializuara të gjykojnë dhe funksionojë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (“Kushtetuta”) dhe me të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Gjithashtu, Kushtetuta parashikon zbatimin e drejtpërdrejtë të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“KEDNJ”), si dhe të garancive për gjykim të drejtë të përfshira në nenin 6, dhe të të drejtave dhe liritë themelore të njeriut të garantuara në Kushtetutë, dhe kërkon që ato të interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“GJEDNJ”).<sup>37</sup> Garancitë mbrojtëse të nenit 6 të KEDNJ-së përfshihen, ndër të tjera, në nenet 21 dhe 38(3) të Ligjit, rregullat 42 deri 44 të Rregullores, dhe në nenin 30 të Kushtetutës.

12. Paneli do të trajtojë së pari Pikën e Tretë të Krasniqit. Më pas, do të trajtojë së bashku Pikën e Parë të Krasniqit dhe Pikën e Tretë të Selimit, pasi në to ngrihen të njëjtat shqetësime themelore. Në fund, Paneli i Apelit do të trajtojë Pikën e Nëntë të Krasniqit.

---

<sup>36</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 16.

<sup>37</sup> Nenet 22(2) dhe 53 të Kushtetutës. Shih gjithashtu KSC-CC-2019-05, F00012, Vendim mbi Referimin e Mahir Hasanit në lidhje me Urdhrin e Prokurorisë të 20 Dhjetorit 2018, 20 shkurt 2019 (“Vendimi i Gjykatës Kushtetuese për *Mahir Hasanin*”), para. 25.

A. NËSE TRUPI GJYKUES GABOI QË KONSTATOI SE Z. KRASNIQI NUK KISHTE TË DREJTËN E GARANCIVE QË I JEPEN PERSONIT TË DYSHUAR NË KOHËN E DHËNIES SË PROVAVE PËR TPNJ-NË (PIKA E TRETË E KRASNIQIT)

### 1. Parashtrimet e palëve

13. Krasniqi parashtroi se Trupi Gjykses gaboi që konstatoi se Krasniqi – i cili në kohën për të cilën bëhet fjalë ishte dëshmitar – nuk kishte të drejtë të gëzonte garancitë për gjykim të drejtë që i jepen një personi të dyshuar.<sup>38</sup> Krasniqi argumenton në vend që Trupi Gjykses të kryente analizën e vet nëse TPNJ-ja duhej ta kishte trajtuar atë si person të dyshuar, me të drejtat përkatëse, Trupi Gjykses gaboi që e trajtoi si përfundimtar përcaktimin e Krasniqit nga TPNJ-ja i dëshmitar.<sup>39</sup> Ai parashtroi se, në ndryshim nga qasja e përdorur në lidhje me një të bashkakuzuar, Trupi Gjykses nuk bëri asnjë vlerësim të pavarur për këtë.<sup>40</sup> Ai pretendon se provat e Krasniqit për TPNJ-në duhet të përjashtohen ose sipas rregullës 138(1) të Rregullores, pasi vlera provuese e këtyre provave zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre, ose, si alternativë, në bazë të rregullës 138(2) të Rregullores dhe nenit 55 të Kushtetutës, pasi provat u siguruan përmes shkeljes të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.<sup>41</sup>

14. Krasniqi gjithashtu argumenton se për të përcaktuar nëse janë të zbatueshme garancitë e parashikuara në nenin 6 të KEDNJ-së, ndër to dhe e drejta për të mos inkriminuar veten, jurisprudenca e GJEDNJ-së përdor qasjen “materiale dhe jo formale” dhe se është e domosdoshme të shihet përtej përcaktimit procedural që i

---

<sup>38</sup> Apeli i Krasniqit, para. 4, 28. Shih gjithashtu Apelin e Krasniqit, para. 16; Kundërpërgjigjen e Krasniqit, para. 10.

<sup>39</sup> Apeli i Krasniqit, para. 29, 33. Shih gjithashtu Apelin e Krasniqit, para. 27, 38; Kundërpërgjigjen e Krasniqit, para. 12-13.

<sup>40</sup> Apeli i Krasniqit, para. 33, që i referohet paragrafit 129 të Vendimit të Kundërshtuar (në lidhje me Thaçin).

<sup>41</sup> Apeli i Krasniqit, para. 38, 52.

është bërë parashtruesit, si dhe të vlerësohet në thelb nëse autoritetet zotëronin informacion që e inkriminonte atë.<sup>42</sup>

15. Së fundi, Krasniqi argumenton se TPNJ-ja duhej ta kishte trajtuar atë si të dyshuar pasi, në bazë të rregullës 2(A) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave të TPNJ-së (“Rregullorja e TPNJ-së”), ai ishte “person për të cilin prokurori zotëron informacion në të cilin mund të mbështetesh, që tregon se personi mund të ketë kryer një krim që përfshihet në juridiksionin e Tribunalit”.<sup>43</sup> Në mbështetje të këtij parashtrimi, Krasniqi shton se, duke qenë se ZPS-ja argumenton se provat e Krasniqit për TPNJ-në japin informacion në të cilin mund të mbështetesh në lidhje me rolin dhe deklaratat publike të tij, si dhe tregojnë se Krasniqi mund të ketë kryer krime, nga kjo rrjedh se në vitet 2005 dhe 2007, po ky material – për të cilin Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se përbënte bazë të mjaftueshme për çështjen aktuale – ishte informacion në të cilin mund të mbështetesh që tregonte se Krasniqi mund të ketë kryer krime.<sup>44</sup> Krasniqi shton më tej se praktika e ZPS-së konfirmon se një person duhet të trajtohet si i dyshuar sa herë që prokuroria zotëron materiale që sugjerojnë përfshirjen e personit në krime.<sup>45</sup>

---

<sup>42</sup> Apeli i Krasniqit, para. 30-32, ku i referohet ECtHR, *Deweere v. Belgium*, no. 6903/75, Judgment, 27 February 1980 (“*Deweere Judgment*”), para. 44, ECtHR, *Kalēja v. Latvia*, no. 22059/08, Judgment, 5 October 2017 (“*Kalēja Judgment*”); paras 36-41; ECtHR, *Simeonovi v. Bulgaria*, no. 21980/04, Judgment, 12 May 2017 (“*Simeonovi Judgment*”), para. 110; ECtHR, *Ibrahim and Others v. The United Kingdom*, nos 50541/08, 50571/08, 50573/08 and 40351/09, Judgment, 13 September 2016 (“*Ibrahim and Others Judgment*”), para. 249; ECtHR, *Aleksandr Zaichenko v. Russia*, no. 39660/02, Judgment, 18 February 2010 (“*Zaichenko Judgment*”), para. 52; ECtHR, *Schmid-Laffer v. Switzerland*, no. 41269/08, Judgment, 16 June 2015 (“*Schmid-Laffer Judgment*”), para. 29. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen e Krasniqit, para. 11.

<sup>43</sup> Apeli i Krasniqit, para. 34.

<sup>44</sup> Apeli i Krasniqit, para. 36-37. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen e Krasniqit, para. 14, ku Krasniqi argumenton se (i) “një sasi e konsiderueshme informacioni disponohej nga [prokuroria e TPNJ-së] të paktën që nga viti 2005 dhe tani po përdoret për të mbështetur akuza kundër [tij]”; (ii) lënda e çështjeve gjyqësore *Limaj dhe të tjerët* dhe *Haradinaj dhe të tjerët*, përkon me procesin aktual; dhe (iii) Trupi Gjykues mbajti shënim temat e trajtuara në dëshmitë dhe deklaratën e Krasniqit në TPNJ, në të cilat synon të mbështetet ZPS-ja.

<sup>45</sup> Apeli i Krasniqit, para. 35. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen e Krasniqit, para. 14.

16. ZPS-ja përgjigjet se Trupi Gjykues konstatoi saktë se në kohën kur Krasniqi dha provat e tij para TPNJ-së, ai nuk kishte të drejtën e garancive mbrojtëse të një të dyshuari.<sup>46</sup> Konkretisht, ZPS-ja parashtroi se, megjithëse Krasniqi bazohet në jurisprudencën e GJEDNJ-së për të mbështetur pretendimin se dëshmitari duhet të trajtohet si i dyshuar kur ekziston dyshimi ose ka prova inkriminuese kundër atij personi, nuk ka asgjë të sugjerojë se TPNJ-ja e cilësoi, trajtoi ose duhej ta kishte trajtuar Krasniqin si të dyshuar.<sup>47</sup> ZPS-ja parashtroi më tej se argumentet e vetë Krasniqit tregojnë se nuk ka asnjë arsye të dukshme që TPNJ-ja ta trajtonte atë si të dyshuar.<sup>48</sup> Sipas saj, përmendja prej Krasniqit për këtë qëllim (i) e akuzave dhe provave të çështjes gjyqësore dhe (ii) e deklaratave të mëhershme të tij për rolin dhe deklaratat publike të tij, janë të pamjaftueshme për të demonstruar gabim të Trupit Gjykues, apo statusin që kishte ai në TPNJ.<sup>49</sup>

17. Gjithashtu, në kundërshtim me parashtimet e Krasniqit, ZPS-ja përgjigjet se Trupi Gjykues nuk e konstatoi vendimtar cilësimin e Krasniqit si dëshmitar prej TPNJ-së, por e konsideroi këtë cilësim si një faktor në vlerësimin e përgjithshëm nëse Krasniqi kishte pasur të drejtën e trajtimit si i dyshuar dhe deri në çfarë mase.<sup>50</sup>

18. Krasniqi kundërpërgjigjet se ZPS-ja nuk mund të lejohet të marrë qëndrime kundërthënëse dhe të mbështetet në prova të TPNJ-së si bazë për ndjekjen penale të tij, ndërkohë që përpiket, në të njëjtën kohë, që të kundërshtojë në mënyrë oportuniste apelin e tij duke pretenduar se i njëjti material nuk përbënte “arsye të dukshme” për ta konsideruar atë të dyshuar.<sup>51</sup>

---

<sup>46</sup> Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 22. Shih gjithashtu Përgjigjen Përmbledhëse të ZPS-së, para. 2.

<sup>47</sup> Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 21.

<sup>48</sup> Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 21.

<sup>49</sup> Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 21.

<sup>50</sup> Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 20.

<sup>51</sup> Kundërpërgjigjja e Krasniqit, para. 14.

## 2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

19. Fillimisht, Paneli i Apelit do të trajtojë kushtet për zbatimin e garancive mbrojtëse të nenit 6 të KEDNJ-së sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së. Paneli i Apelit rikujton se garancitë mbrojtëse të përcaktuara në nenin 6(1) të KEDNJ-së, zbatohen për një person që është objekt i një “akuze penale”.<sup>52</sup> Paneli vëren se GJEDNJ-ja ka përdorur qasjen materiale përkundër asaj formale për t’i dhënë përgjigje pyetjes se kur një person mund të konsiderohet se është objekt i një akuze penale.<sup>53</sup> GJEDNJ-ja ka konfirmuar se “akuza penale” ekziston jo vetëm që prej momentit që personi njoftohet zyrtarisht nga autoriteti kompetent për pretendimin se ka kryer një vepër penale, por edhe që prej momentit kur situata e personit “ndikohet në mënyrë të konsiderueshme”.<sup>54</sup> Është gjykuar se kjo ndodh, për shembull, kur personi arrestohet me dyshimin se ka kryer vepër penale,<sup>55</sup> kur personi merret në pyetje për rolin e tij në veprime që përbëjnë vepër penale,<sup>56</sup> ose që prej momentit kur personi fillon të inkriminojë veten<sup>57</sup> ose pranon se ka kryer krimin.<sup>58</sup> Paneli i Apelit pajtohet me Krasniqin se ky përcaktim bëhet pavarësisht nëse personi trajtohet nga ana formale si dëshmitar dhe se ai status nuk duhet të konsiderohet faktor vendimtar.<sup>59</sup> Paneli gjithashtu konsideron se jurisprudenca e GJEDNJ-së në lidhje me zbatueshmërinë e garancive mbrojtëse të nenit 6 përputhet me moton e saj – të cilën e konsideron me

<sup>52</sup> Shih *Simeonovi* Judgment, para. 110; *Ibrahim and Others* Judgment, para. 249. Shih gjithashtu Vendimin e Gjykatës Kushtetuese për *Mahir Hasanin*, para. 29.

<sup>53</sup> Shih *Deweer* Judgment, para. 44. Shih gjithashtu Vendimin e Gjykatës Kushtetuese për *Mahir Hasanin*, para. 29; Krasniqi Appeal, para. 30.

<sup>54</sup> Shih *Deweer* Judgment, para. 46; *Ibrahim and Others* Judgment, para. 249; ECtHR, *Eckle v. Germany*, no. 8130/78, Judgment, 15 July 1982, para. 73; *Zaichenko* Judgment, para. 42. Shih gjithashtu Vendimin e Gjykatës Kushtetuese për *Mahir Hasanin*, para. 30.

<sup>55</sup> ECtHR, *Brusco c. France*, no. 1466/07, Arrêt, 14 October 2010, paras 47-50; *Simeonovi* Judgment, para. 121.

<sup>56</sup> *Zaichenko* Judgment, paras 41-43; *Schmid-Laffer* Judgment, para. 31.

<sup>57</sup> *Ibrahim and Others* Judgment, para. 296 (GJEDNJ-ja konstatoi se “në atë moment ishte kristalizuar dyshimi se [personi] kishte kryer vepër penale”).

<sup>58</sup> ECtHR, *Yankov and Others v. Bulgaria*, no. 4570/05, Judgment, 23 September 2010, para. 23; ECtHR, *Shabelnik v. Ukraine*, no. 16404/03, Judgment, 19 February 2009, para. 57.

<sup>59</sup> *Kalēja* Judgment, paras 38, 40. Shih gjithashtu *Schmid-Laffer* Judgment, paras 29, 31; *Ibrahim and Others* Judgment, para. 296. Shih Apelin e Krasniqit, para. 30.

relevancë të veçantë për të drejtat e mbrojtjes<sup>60</sup> – se KEDNJ-ja “ka për qëllim të garantojë jo të drejtat që janë teorike apo joreale, por praktike dhe të efektshme”.<sup>61</sup>

20. Paneli rikujton konstatimin e Trupit Gjykses se “një person që intervistohet si dëshmitar nuk gëzon të njëjtat garanci mbrojtëse të procesit ligjor të rregullt si ato që i jepen një të dyshuari, nëse në kohën e intervistës, nuk konsiderohet ose trajtohet si i dyshuar, pavarësisht nëse më vonë bëhet i dyshuar ose i akuzuar”.<sup>62</sup> Paneli i Apelit arrin në përfundimin se ky konstatim përputhet me jurisprudencën e lartpërmendur, në kuptimin që garancitë që i jepen të dyshuarit sipas nenit 6 të KEDNJ-së bëhen të zbatueshme vetëm nga momenti kur personi konsiderohet si i dyshuar ose nga momenti kur ai *duhej të ishte trajtuar* si i dyshuar.

21. Në vijim, Paneli i Apelit do të trajtojë nëse Krasniqi duhej të ishte trajtuar si i dyshuar dhe, në veçanti, argumentin e Krasniqit se Trupi Gjykses gaboi që e gjykoi si përcaktues cilësimin formal prej TPNJ-së të tij si dëshmitar.<sup>63</sup> Paneli i Apelit vëren se Trupi Gjykses parashikoi një sërë situatash të veçanta që do të favorizonin që personit që paraqitet para gjykatës si dëshmitar t’i akordohen të drejtat e një të dyshuari, siç është rasti i veprimit të pandershëm nga ana e autoriteteve, apo situatat kur përgjigjet e dhëna nga personi i intervistuar përmbajnë tregues të qartë për përfshirjen e personit në kryerjen e një krimi.<sup>64</sup> Gjatë marrjes së vendimit mbi pranimin e disa deklaratave ose dëshmive specifike të katër të bashkakuzuarve, Trupi Gjykses analizoi posaçërisht aspektin nëse prokuroria e TPNJ-së dhe/ose PSRK-ja kishte vepruar në mënyrë të paarsyeshme ose të pandershme kur i kishte trajtuar të bashkakuzuarit si dëshmitarë, dhe shqyrtoi nëse ata duhej të ishin trajtuar në fakt si të dyshuar.<sup>65</sup> Sipas Panelit të

<sup>60</sup> ECtHR, *Artico v. Italy*, no. 6694/74, Judgment, 13 May 1980 (“*Artico Judgment*”), para. 33.

<sup>61</sup> *Artico Judgment*, para. 33.

<sup>62</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 129, që i referohet *Ibrahim and Others Judgment*, para. 270; *Schmid-Laffer Judgment*, paras 29, 39.

<sup>63</sup> Shih Apelin e Krasniqit, para. 29.

<sup>64</sup> Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 129.

<sup>65</sup> Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 129 (në lidhje me deklaratën e Thaçit dhënë PSRK-së në nëntor 2011, Trupi Gjykses u shpreh se “asgjë nuk sugjeron se gjatë intervistës statusi i z. Thaçi duhet të kishte

Apelit, kjo tregon se Trupi Gjykses nuk e trajtoi si përcaktues cilësimin që iu bë në fillim të bashkakuzuarve si dëshmitarë në lidhje me këto prova konkrete.

22. Sidoqoftë, Paneli vëren se Vendimi i Kundërshtuar nuk përmban një vlerësim të tillë në lidhje me provat e Krasniqit në TPNJ-në, të cilat kundërshtohen specifikisht në apel. Në fakt, Trupi Gjykses nuk e shtjelloi këtë pikë në arsyetimin e tij në lidhje me dëshminë e shkurtit 2005 të dhënë nga Krasniqi në procesin gjyqësor të TPNJ-së, dëshminë e majit 2007 të dhënë nga Krasniqi në procesin gjyqësor të TPNJ-së dhe në deklaratën si dëshmitar të Krasniqit dhënë TPNJ-së në maj 2007.<sup>66</sup> Megjithatë, në mungesë të ndonjë sugjerimi për veprim të pandershëm dhe/ose të paarsyeshëm nga autoritetet e ndjekjes penale të TPNJ-së, dhe në mungesë ndonjë treguesi për aktivizimin e së drejtës së mosinkriminimit të vetes në intervistat dhe/ose deklaratat e z. Krasniqi kur u morën ato prova, Paneli konstaton se Trupi Gjykses nuk kishte arsye të shtjellonte nëse Krasniqi duhej të ishte trajtuar si i dyshuar apo jo.

23. Në lidhje me këtë, Paneli i Apelit thekson se Mbrojtja e Krasniqit nuk evidenton asnjë rast nga deklaratat dhe dëshmitë e tij në TPNJ që z. Krasniqi të jetë pyetur për përfshirjen e tij në krime, që, sipas jurisprudencës së lartpërmendur të GJEDNJ-së, do

---

ndryshuar në atë të një të dyshuari”), 135 (në lidhje me deklaratën e Thaçit dhënë prokurorisë së TPNJ-së në maj 2004, “nuk ka prova se prokurori i TPNJ-së veproi në mënyrë të pandershme, dhe nga procesverbali i intervistës nuk del se përgjigjet e z. Thaçi bënë që prokurori ta rishikonte qëndrimin e tij në lidhje me statusin e Thaçit si dëshmitar e jo si i dyshuar”), 141 (në lidhje me deklaratën e Selimit dhënë PSRK-së në shtator 2011, “nuk ka tregues se PSRK-ja ka vepruar në mënyrë të pandershme ose të paarsyeshme, kur e trajtoi z. Selimi si dëshmitar dhe jo si të dyshuar”), 144 (në lidhje me deklaratën e Selimit dhënë PSRK-së në qershor 2013, “Trupi Gjykses nuk do të përpiqet të hamendësojë për pikëpamjet e [autoriteteve hetimore], kur nuk ka tregues se autoritetet hetimore vepruan në mënyrë të pandershme ose të paarsyeshme në atë rast”), 156 (në lidhje me deklaratën e Selimit dhënë prokurorisë së TPNJ-së në prill 2004, “Trupi Gjykses konstaton se në këto rrethana, nuk ka tregues se prokurori i TPNJ-së veproi në mënyrë të pandershme apo të paarsyeshme kur vendosi ta trajtojë z. Selimi si dëshmitar e jo si të dyshuar”), 168 (në lidhje me një deklaratë të Veselit dhënë PSRK-së në vitet 2010/2011, “ka asnjë tregues për ndonjë veprim të pandershëm apo të paarsyeshëm nga autoritetet në trajtimin e tij si dëshmitar e jo si i dyshuar në rrethanat e asaj kohe”), 191 (në lidhje me dëshminë e Krasniqit në procesin gjyqësor të PSRK-së në shkurt 2018, “nuk ka asnjë tregues se PSRK-ja e shkeli këtë garanci ose se veproi në mënyrë të pandershme ose të paarsyeshme kur e intervistoi z. Krasniqi si dëshmitar e jo si të dyshuar”).

<sup>66</sup> Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 194, 200, 204.

të kishte aktivizuar zbatimin e garancive mbrojtëse të nenit 6.<sup>67</sup> Paneli po kështu vëren pretendimin e Krasniqit se informacioni që pretendohet se dispononte prokuroria e TPNJ-së në atë kohë, tani po përdoret për të mbështetur akuzat kundër tij, dhe se procesi penal i TPNJ-së ku ai dha dëshmi si dëshmitar kishte të bënte me krime që pretendohet se u kryen në të njëjtat vende si ato për të cilat akuzohet në këtë çështje gjyqësore.<sup>68</sup> Sidoqoftë, Paneli i Apelit nuk është bindur se kjo tregon që situata e Krasniqit mund të konsiderohej si “e ndikuar në masë të konsiderueshme” në kohën e marrjes së dëshmisë në TPNJ dhe se ai duhej të ishte konsideruar si i dyshuar në atë kohë, sipas nenit 6 të KEDNJ-së.<sup>69</sup> Rrjedhimisht, Paneli nuk konstaton gabim në vendimin e Trupit Gjykses për të mos devijuar prej cilësimit të përdorur nga TPNJ-ja.<sup>70</sup>

24. Bazuar në sa më lart, Paneli i Apelit konstaton se Trupi Gjykses nuk gaboi që arriti në përfundimin se Krasniqi nuk kishte të drejtën e garancive mbrojtëse që i jepen një personi të dyshuar në kohën kur dha provat e tij për TPNJ-në.<sup>71</sup> Rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzon Pikën e Tretë të Krasniqit.

B. NËSE TRUPI GJYKUES GABOI QË PRANOI PROVAT E KRASNIQIT DHËNË TPNJ-SË DHE PROVAT E SELIMIT DHËNË TPNJ-NË DHE PSRK-NË, NË SHKELJE TË SË DREJTËS SË TYRE PËR TË MOS INKRIMINUAR VETEN (PIKA E PARË E KRASNIQIT; PIKA E TRETË E SELIMIT)

### 1. Parashtrimet e palëve

25. Krasniqi fillimisht parashtron se atij iu shkel e drejta e mosinkriminimit të vetes për shkak të mënyrës se si u morën provat e tij në TPNJ, pasi ai “u detyrua të bënte deklaratat vetinkriminuese në TPNJ” nën kërcënimin e sanksionit dhe pa u informuar

<sup>67</sup> Shih më lart, para. 19.

<sup>68</sup> Shih Kundërpërgjigjen e Krasniqit, para. 14.

<sup>69</sup> Shih p.sh. *Deweer* Judgment, para. 46; *Zaichenko* Judgment, paras 42-43; *Schmid-Laffer* Judgment, para. 31. Shih Apelin e Krasniqit, para. 34-37; Kundërpërgjigjen e Krasniqit, para. 14.

<sup>70</sup> Shih Apelin e Krasniqit, para. 29, 33.

<sup>71</sup> Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 194, 200, 204.

për të drejtën e mosinkriminimit të vetes.<sup>72</sup> Ai pretendon se, pavarësisht nga kjo, Trupi Gjykues arriti në përfundimin se provat e Krasniqit në TPNJ u dhanë vullnetarisht, pa shtrëngim ose detyrim, dhe në një mënyrë që ishte në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe, për rrjedhojë, Trupi Gjykues i pranoi ato.<sup>73</sup> Më konkretisht, Krasniqi parashtron se Trupi Gjykues gaboi që konstatoi se: (i) provat e Krasniqit për TPNJ-në u dhanë vullnetarisht, sepse Krasniqi nuk kërkoi aktivizimin e së drejtës së mosinkriminimit të vetes;<sup>74</sup> (ii) “urdhërparaqitja, betimi solemn dhe mungesa e informimit për të drejtën e mosinkriminimit të vetes, nuk ndikuan në dhënien vullnetarisht të dëshmisë prej tij”;<sup>75</sup> dhe (iii) prokuroria e TPNJ-së nuk kishte detyrim ta paralajmëronte Krasniqin për vetinkriminimin.<sup>76</sup> Ai shton se u la para “tri alternativave mizore”, konkretisht, që të zgjidhte midis vetinkriminimit, dëshmisë së rreme, ose mosbindjes ndaj gjykatës.<sup>77</sup>

26. Krasniqi gjithashtu parashtron se pranimi dhe më pas përdorimi i provave të Krasniqit për TPNJ-në kundër tij në Dhomat e Specializuara, shkel të drejtën e tij për të mos inkriminuar veten.<sup>78</sup> Sipas tij, këto prova, si rezultat, duhet të përjashtohen.<sup>79</sup> Duke u mbështetur në jurisprudencën e TPNJ-së dhe GJEDNJ-së,<sup>80</sup> Krasniqi argumenton se Trupi Gjykues gaboi që arriti në përfundimin se për pranimin si provë

<sup>72</sup> Apeli i Krasniqit, para. 7, 11, 14, 17, 26. Shih gjithashtu Apelin e Krasniqit, para. 2; Kundërpërgjigjen e Krasniqit, para. 4, 9.

<sup>73</sup> Apeli i Krasniqit, para. 9. Shih gjithashtu Apelin e Krasniqit, para. 13-14.

<sup>74</sup> Apeli i Krasniqit, para. 10, 12. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen e Krasniqit, para. 6.

<sup>75</sup> Apeli i Krasniqit, para. 10. Shih gjithashtu Apelin e Krasniqit, para. 13-15; Kundërpërgjigjen e Krasniqit, para. 4-5, 9.

<sup>76</sup> Apeli i Krasniqit, para. 10, 12. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen e Krasniqit, para. 5-7.

<sup>77</sup> Apeli i Krasniqit, para. 14. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen e Krasniqit, para. 5, ku Krasniqi pretendon se ai “realisht nuk kishte tjetër alternativë” përpos që të konfirmonte vërtetësinë e dëshmive të tij të mëhershme.

<sup>78</sup> Apeli i Krasniqit, para. 17, 22. Shih gjithashtu Apelin e Krasniqit, para. 4, 24.

<sup>79</sup> Apeli i Krasniqit, para. 26, 52.

<sup>80</sup> Apeli i Krasniqit, para. 17-21, që u referohet ECtHR, *Saunders v. The United Kingdom*, no. 19187/91, Judgment, 17 December 1996 (“*Saunders Judgment*”), paras 60, 68-70, 74-75; ICTY, *Prosecutor v. Delalić et al.*, IT-96-21-T, Decision on Zdravko Mucić’s Motion for the Exclusion of Evidence, 2 September 1997 (“*Delalić et al. Trial Chamber Decision*”), paras 48-52, 55; ICTY, *Prosecutor v. Halilović*, IT-01-48-T, Decision on Motion for Exclusion of Statement of Accused, 8 July 2005 (“*Halilović Trial Chamber Decision*”), para. 21.

të një deklarate të dhënë nga një dëshmitar, i cili në kohën e dhënies së saj nuk konsiderohej i dyshuar, nuk është e nevojshme që ai të informohet për të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ka një i dyshuar.<sup>81</sup>

27. Krasniqi në fund pretendon se Trupi Gjykses gaboi që e përlegji pranimin e provave të Krasniqit për TPNJ-në me arsyen se garancitë mbrojtëse të rregullës 90(E) e Rregullores së TPNJ-së nuk kanë efekt jashtë juridiksionit të TPNJ-së, çka pengon përdorimin e saj në Dhomat e Specializuara.<sup>82</sup> Ndonëse i vetëdijshëm se rregulla 90(E) e Rregullores së TPNJ-së nuk është e zbatueshme në Dhomat e Specializuara, Krasniqi pretendon se ai është vënë në një “zbrazëti ligjore”, ku ai nuk mbrohet nga ajo dispozitë, pasi nuk është para TPNJ-së dhe nuk mbrohet nga Rregullorja e Dhomave të Specializuara, pasi provat nuk u morën nga Dhomat e Specializuara.<sup>83</sup>

28. Selimi u paraprin parashtrimeve të tij me argumentin se asnjë prej provave të tij dhënë TPNJ-së dhe PSRK-së, nuk u mor në një mënyrë që është në përputhje me të drejtat e një të dyshuari.<sup>84</sup> Sipas tij, Trupi Gjykses bëri gabim juridik që nuk përcaktoi standardin e saktë juridik për situatat në të cilat përdorimi kundër një personi i dëshmimeve të mëparshme me gjasë vetinkriminuese, shkel të drejtën e tij për gjykim të drejtë.<sup>85</sup> Ai argumenton se ky gabim e bën të pavlefshëm Vendimin e Kundërshtuar dhe i kërkon Panelit të Apelit të prapësojë Vendimin e Kundërshtuar në lidhje me pranimin e provave të Selimit dhënë TPNJ-së dhe PSRK-së, të përcaktojë standardin e saktë juridik dhe ta zbatojë atë në lidhje me aspektin e pranimi të tyre.<sup>86</sup>

---

<sup>81</sup> Apeli i Krasniqit, para. 22. Shih gjithashtu Apelin e Krasniqit, para. 10, 16.

<sup>82</sup> Apeli i Krasniqit, para. 23. Shih gjithashtu Apelin e Krasniqit, para. 24-25.

<sup>83</sup> Apeli i Krasniqit, para. 23-24.

<sup>84</sup> Apeli i Selimit, para. 2, 7-11. Shih gjithashtu Apelin e Selimit, para. 43-44. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen e Selimit, para. 6-7, ku Selimi pretendon se thjesht fakti se ai u ndihmua nga mbrojtësi, nuk bën që pranimi i provave të tij dhënë TPNJ-së dhe PSRK-së të jetë në përputhje me të drejtën për të heshtur dhe të drejtën për të mos inkriminuar veten. Ai gjithashtu pretendon se ishte pranimi i provave të mbledhura pikërisht në rrethana të tilla që çoi në konstatimin e GJEDNJ-së për shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së në çështjen gjyqësore *Saunders*.

<sup>85</sup> Apeli i Selimit, para. 42.

<sup>86</sup> Apeli i Selimit, para. 42-46.

29. Më konkretisht, Selimi fillimisht pretendon se tribunalëve penalë ndërkombëtarë u ndalohet përdorimi i dëshmive vetinkriminuese të marra me detyrim.<sup>87</sup> Ai shton se ky përdorim mund të çojë në konstatim për shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së.<sup>88</sup> Ndonëse saktëson se nuk po argumenton se rregulla 90(E) e Rregullores së TPNJ-së duhet të zbatohet drejtpërdrejt në procesin aktual, Selimi parashton se Trupi Gjykses bëri një interpretim të ngushtë e të papërligjur kur konstatoi se rregulla 90(E) e Rregullores së TPNJ-së nuk kishte zbatim dhe as nuk synohej të kishte zbatim juridiksionit të TPNJ-së.<sup>89</sup> Sipas tij, rregulla 90(E) e Rregullores së TPNJ-së dhe rregulla 151(3)(b) e Rregullores pasqyrojnë një standard universal të të drejtave për gjykim të drejtë sipas të cilit “dëshmia e një dëshmitari që detyrohet të japë dëshmi në shkelje të së drejtës për të heshtur dhe për të mos inkriminuar veten, nuk mund të përdoret kundër atij dëshmitari në qoftë se ai bëhet i akuzuar”.<sup>90</sup>

30. Së dyti, Selimi argumenton se deklaratat e mëhershme si dëshmitar mund të përdoren kundër një të akuzuari vetëm në qoftë se ai informohet dhe paralajmërohet për të drejtat dhe detyrimet dhe për garancitë mbrojtëse sipas ligjit.<sup>91</sup> Selimi parashton se Trupi Gjykses gaboi që nuk mori parasysh jurisprudencën ndërkombëtare që konfirmon këtë qëndrim bazuar në një sërë faktorësh dallues që janë “si juridikisht arbitrarë, ashtu edhe faktikisht të pasaktë”.<sup>92</sup> Në këtë aspekt, Selimi i referohet jurisprudencës së TPNJ-së dhe GJEDNJ-së, dhomat gjyqësore të të cilave, sipas tij, arritën në përfundimin se “në mungesë të garancive [të nenit 6], [...] provat

---

<sup>87</sup> Apeli i Selimit, para. 11-14. Shih gjithashtu Apelin e Selimit, para. 43. Selimi bën parashtrime të mëtejshme në lidhje me “standardin” e përcaktimit të detyrimit në jurisprudencën e GJEDNJ-së. Shih Apelin e Selimit, para. 15-17, 20. Shih gjithashtu Apelin e Selimit, para. 18-19.

<sup>88</sup> Apeli i Selimit, para. 16-17, që i referohen *Saunders Judgment*; ECtHR, *Kansal v. The United Kingdom*, no. 21413/02, Judgment, 27 April 2004 (“*Kansal Judgment*”). Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen e Selimit, para. 14.

<sup>89</sup> Apeli i Selimit, para. 12, 21-26; Kundërpërgjigjja e Selimit, para. 10-11.

<sup>90</sup> Apeli i Selimit, para. 14, 22-23. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen e Selimit, para. 11.

<sup>91</sup> Apeli i Selimit, para. 11, 27-33, 41. Shih gjithashtu Apelin e Selimit, para. 4-5, 10, 44; Kundërpërgjigjen e Selimit, para. 3.

<sup>92</sup> Apeli i Selimit, para. 34-41. Shih gjithashtu Apelin e Selimit, para. 45; Kundërpërgjigjen e Selimit, para. 15.

nuk mund të pranohen.”<sup>93</sup> Gjithashtu, Selimi parashtroi se deklarata e dhënë si dëshmitar kundër një personi mund të pranohet vetëm në rast të heqjes dorë në mënyrë të vlefshme nga e drejta për të mos inkriminuar veten dhe e drejta për të heshtur, dhe kjo heqje dorë presupozon se dëshmitari “kishte dijeni për ekzistencën e kësaj të drejte dhe pasojat që rrjedhin nga heqja dorë e mundshme prej saj”.<sup>94</sup> Gjithashtu, ai pretendon se, në kundërshtim me konstatimin e Trupit Gjykses se provat e tij u dhanë vullnetarisht, pa shtrëngim dhe detyrim të palejueshëm, dhënia e dëshmisë vullnetarisht, pa ushtrim të shtrëngimit, nuk përbën heqje dorë të vlefshme.<sup>95</sup>

31. ZPS-ja përgjigjet se, Selimi nuk arrin të përmbushë detyrimin e vërtetimit në apel duke bërë parashtrime me karakter të përgjithshëm, të cilat ai pretendon se vlejné për tërësinë e provave të Selimit dhënë TPNJ-së dhe PSRK-së, dhe duke mos u thelluar sa duhet në analizën dhe konstatimet e kujdesshme të Trupit Gjykses për secilin material.<sup>96</sup> Po kështu, sa i takon Krasniqit, ZPS-ja argumenton se në argumentet e tij shpesh nuk bëhet dallim mes rrethanave në të cilat u morën deklaratat e ndryshme në TPNJ dhe, në disa raste, ai shtrembëron dokumentacionin.<sup>97</sup> ZPS-ja parashtroi se provat e Krasniqit për TPNJ-në dhe provat e Selimit për TPNJ-në dhe PSRK-në, u dhanë vullnetarisht, pa detyrim të palejueshëm dhe u morën në përputhje me

<sup>93</sup> Apeli i Selimit, para. 27 (që i referohet Vendimit të Dhomës së Gjykitimit në çështjen *Halilović*), 28 (që i referohet ICTY, *Prosecutor v. Prlić et al.*, IT-04-74-T, Decision on the Admission into Evidence of Slobodan Praljak’s Evidence in the Case of Naletelić and Martinović, 5 September 2007 (“*Prlić et al.* Trial Chamber Decision”)), 31 (që i referohet *Delalić et al.* Trial Chamber Decision), 32 (që i referohet ECtHR, *Lutsenko v. Ukraine*, no. 30663/04, Judgment, 18 December 2008 (“*Lutsenko* Judgment”)), 33 (që i referohet *Schmid-Laffer* Judgment).

<sup>94</sup> Apeli i Selimit, para. 29, që i referohet *Prlić et al.* Trial Chamber Decision, para. 19.

<sup>95</sup> Apeli i Selimit, para. 30, që i referohet Vendimit të Kundërshtuar, para. 141, 144, 147, 150, 153, 156, 161; *Prlić et al.* Trial Chamber Decision, para. 20. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen e Selimit, para. 8.

<sup>96</sup> Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 33. ZPS-ja shton se gjatë intervistave të tij me ZPS-në si i dyshuar dhe si dëshmitar, Selimi dëshmoi në mënyrë të përsëritur për shumë prej po atyre aspekteve që ishin trajtuar në deklarata të tjera, përfshirë deklaratat dhënë TPNJ-së, edhe pasi u informua për të drejtën e tij për të mos iu përgjigjur pyetjeve. Shih Përgjigjen Përmbledhëse të ZPS-së, para. 33.

<sup>97</sup> Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 6, 18.

standardet ndërkombëtare.<sup>98</sup> ZPS-ja gjithashtu argumenton se, në kundërshtim me parashtrimet e Mbrojtjes, e drejta e mosinkriminimit të vetes nuk e mbron personin nga bërja e deklaratave inkriminuese dhe përdorimi i dëshmive vetinkriminuese të marra me detyrim, në vetvete, nuk ndalohej në Dhomat e Specializuara, tribunallet ndërkombëtarë ose nga GJEDNJ-ja, por është më tepër ekzistenca e detyrimit të *palejueshëm* që krijon shqetësim për natyrën vullnetare të provave dhe ndikimin në të drejtën për të mos inkriminuar veten.<sup>99</sup> ZPS-ja shton se jurisprudenca e GJEDNJ-së së cilës i referohen Krasniqi dhe Selimi për aspektin e detyrimit, dallon gjithashtu sepse ka të bëjë me dëshmi vetinkriminuese që kërkonte t'i përdorte i njëjti organ gjyqësor ose të njëjtat autoritete që detyruan dhënien e tyre, përfshirë në rastet kur dëshmitari u trajtua ose duhet të ishte trajtuar si i dyshuar.<sup>100</sup>

32. ZPS-ja gjithashtu argumenton se, në kundërshtim me argumentin e Krasniqit, rregulla 90(E) e Rregullores së TPNJ-së zbatohet pavarësisht nëse dëshmitarët ishin informuar paraprakisht dhe se ky informim nuk ishte i nevojshëm.<sup>101</sup> Në lidhje me zbatimin e rregullës 90(E) të Rregullores së TPNJ-së jashtë juridiksionit të saj, ZPS-ja përgjigjet se Trupi Gjyqësor konstatoi saktë se kjo dispozitë nuk pretendon dhe as është interpretuar se “ofron mbrojtje ndaj ndjekjeve penale të tjera përveç atyre në TPNJ”.<sup>102</sup> ZPS-ja shton se Trupi Gjyqësor refuzoi lejen për apelim të pikës së propozuar nga Selimi në lidhje me këtë, ndaj argumentet përkatëse të tij duhet të hidhen poshtë

<sup>98</sup> Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 6, 12, 17, 27, 31, 33, 37. Shih gjithashtu Përgjigjen Përmbledhëse të ZPS-së, para. 7-11. ZPS-ja shton se as Dhomat e Specializuara e as ZPS-ja nuk ushtruan detyrim për marrjen e provave të Selimit për TPNJ-në dhe PSRK-në. Shih Përgjigjen Përmbledhëse të ZPS-së, para. 36.

<sup>99</sup> Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 17, 36. Shih gjithashtu Përgjigjen Përmbledhëse të ZPS-së, para. 16, 38.

<sup>100</sup> Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 16, 35. Shih gjithashtu Përgjigjen Përmbledhëse të ZPS-së, para. 14.

<sup>101</sup> Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 13.

<sup>102</sup> Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 35. Shih gjithashtu Përgjigjen Përmbledhëse të ZPS-së, para. 14. ZPS-ja shton se e njëjta gjë vlen edhe për rregullën 151(3)(b) të Rregullores. Shih Përgjigjen Përmbledhëse të ZPS-së, para. 35.

menjëherë.<sup>103</sup> ZPS-ja përgjigjet më tej se asnjë prej çështjeve gjyqësore të cilave u referohen Krasniqi dhe Selimi nuk mbështesin ndonjë standard ndërkombëtar që ndalon pranimin e një deklarate kundër një të akuzuari, që u mor në cilësinë e dëshmitarit, ose pranimin nga një juridiksion të dëshmive vetinkriminuese të marra me detyrim prej një juridiksioni tjetër.<sup>104</sup>

33. Sa i përket përdorimit dhe pranueshmërisë së dëshmive të dhëna më parë si dëshmitarë, ZPS-ja parashtron se argumenti i Selimit se të drejtat që i takojnë tani si i dyshuar ose i akuzuar duhet të zbatohen në mënyrë prapavepruese edhe për deklaratat e dhëna si dëshmitar, është i pabazë dhe duhet të hidhet poshtë.<sup>105</sup> ZPS-ja parashtron se çështjet gjyqësore të TPNJ-së të cituara nga Mbrojtja “nuk kanë lidhje me çështjen aktuale dhe/ose dallojnë prej saj” dhe se çështja gjyqësore *Saunders* në GJEDNJ, dallon nga çështja aktuale pasi ajo kishte të bënte me një deponim vetinkriminues të dhënë nga një dëshmitar, që u kërkua të përdorej nga prokuroria në të njëjtën çështje gjyqësore.<sup>106</sup>

34. Së fundi, ZPS-ja parashtron se edhe nëse, për hir të argumentit, do të konstatohej se është bërë një shkelje e kufizuar, pranimi i provave të kundërshtuara është në interes të drejtësisë dhe i drejtë.<sup>107</sup>

35. Në lidhje me argumentin e ZPS-së se Selimi nuk përmbushi detyrimin e tij në apel duke bërë parashtrime me karakter të përgjithshëm, Selimi kundërpërgjigjet se ai ka “evidentuar veçantitë procedurale” të provave të tij për TPNJ-në dhe PSRK-në, dhe shton se ZPS-ja nuk arrin të demonstrojë se pse ai duhet të trajtojë çdo deklaratë të

---

<sup>103</sup> Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 34.

<sup>104</sup> Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 14, 38. Shih gjithashtu Përgjigjen Përmbledhëse të ZPS-së, para. 20.

<sup>105</sup> Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 39, 41. Gjithashtu, ZPS-ja pretendon se asgjë në apel ose në faktet mbështetëse nuk sugjeron se TPNJ-ja ose PSRK-ja e cilësuan, e trajtuan ose duhej ta kishin trajtuar Selimin si të dyshuar. Shih Përgjigjen Përmbledhëse të ZPS-së, para. 40.

<sup>106</sup> Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 40. Shih Përgjigjen Përmbledhëse të ZPS-së, para. 14.

<sup>107</sup> Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 3.

veçantë, e jo të paraqesë argumente që trajtojnë të gjitha karakteristikat relevante të përbashkëta të tyre.<sup>108</sup> Në lidhje me fushëveprimin e zbatimit të rregullës 90(E) të Rregullores së TPNJ-së, Selimi kundërpërgjigjet se, në kundërshtim me pretendimin e ZPS-së, pika e paraqitur prej tij për të cilën nuk u dha leje për apel kishte të bënte ekskluzivisht dëmin e shkaktuar si pasojë, ndërsa Pika e Tretë e Selimit ka të bëjë me aspektin nëse pranimi i atyre provave është në përputhje me të drejtat e tij si i akuzuar.<sup>109</sup> Ai pretendon se asnjë prej burimeve të jurisprudencës të cituara në Vendimin e Kundërshtuar nuk sugjeron se shkelja e të drejtës për gjykim të drejtë do të ishte e lejueshme nëse ndodh në kontekstin e një juridiksioni tjetër.<sup>110</sup>

36. Selimi gjithashtu sqaron se në ankesën e tij ai nuk argumenton se duhej t'i ishin dhënë garancitë përkatëse në kohën kur dha provat për TPNJ-në dhe PSRK-në, por argumenton se *pranimi* i atyre provave kundër tij në procesin aktual mund të përbëjë shkelje.<sup>111</sup>

37. Si Selimi, ashtu dhe Krasniqi, në vijim kundërpërgjigjen se, në kundërshtim me pretendimin e ZPS-së, sipas Vendimit të Kundërshtuar, çështja gjyqësore *Saunders* në GJEDNJ kishte të bënte me “autoritete të ndryshme” dhe, rrjedhimisht, nuk dallon nga situata në çështjen aktuale.<sup>112</sup>

## 2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

38. Paraprakisht, Paneli i Apelit, e ka marrë parasysh argumentin e ZPS-së se Selimi, dhe, në një farë mase, Krasniqi, nuk janë thelluar në analizën e kujdesshme të bërë për çdo material të Trupit Gjyqësor, dhe në vend të kësaj zgjodhën të bënin parashtrime me karakter të përgjithshëm.<sup>113</sup> Paneli vë në dukje se vlerësimi prej Panelit

---

<sup>108</sup> Kundërpërgjigjja e Selimit, para. 5.

<sup>109</sup> Kundërpërgjigjja e Selimit, para. 9-10.

<sup>110</sup> Kundërpërgjigjja e Selimit, para. 11. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen e Selimit, para. 12.

<sup>111</sup> Kundërpërgjigjja e Selimit, para. 3. Shih gjithashtu Apelin e Selimit, para. 10.

<sup>112</sup> Kundërpërgjigjja e Krasniqit, para. 8; Kundërpërgjigjja e Selimit, para. 13.

<sup>113</sup> Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 33. Shih gjithashtu Përgjigjen Përmbledhëse të ZPS-së, para. 6, 18.

i argumenteve të palëve varet nga paraqitja e argumenteve në mënyrë të qartë, të logjikshme dhe shteruese prej palëve.<sup>114</sup> Ndonëse Paneli i Apelit gjykon se do të kishte qenë e preferueshme që të akuzuarit t'i përshkruanin më qartë dhe një nga një rrethanat në të cilat u mor secila provë, çka, sipas tyre, çoi në gabimet e pretenduara të Trupit Gjykues, Paneli i Apelit vlerëson se parashtrimet e tyre janë të mjaftueshme që ai të kryejë vlerësimin e nevojshëm.

39. Paneli i Apelit fillimisht do të trajtojë pretendimin e të akuzuarve se provat e Krasniqit dhe Selimit u morën në një mënyrë që nuk është në përputhje me të drejtat e një të dyshuari.<sup>115</sup> Fillimisht, Paneli i Apelit vë në dukje se Selimi nuk argumenton se duhej t'i ishin akorduar garancitë mbrojtëse që i jepen një të dyshuari kur dha provat e tij për TPNJ-në ose PSRK-në.<sup>116</sup> Lidhur me Krasniqin, Paneli rikujton konstatimin e tij më sipër se Trupi Gjykues nuk gaboi që e trajtoi atë si të dyshuar në kohën kur dha provat për TPNJ-në.<sup>117</sup> Pavarësisht nëse Krasniqit dhe Selimit nuk iu akorduan, kur dhanë provat e tyre, disa ose të gjitha garancitë që i jepen një të dyshuari – të përcaktuara, ndër të tjera, në nenin 38(3) të Ligjit dhe rregullat 42 deri 44 të Rregullores<sup>118</sup> – në atë kohë ata nuk e kishin të drejtën e atyre garancive sepse neni 6 i KEDNJ-së nuk ishte i zbatueshëm për dëshmitarët. Si rezultat, fakti që në atë kohë atyre nuk iu akorduan këto garanci, në vetvete nuk përbën shkelje të standardeve të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut sipas rregullës 138(2) të Rregullores. Në atë kuptim, Paneli i Apelit nuk sheh gabim në konstatimin e Trupit Gjykues se TPNJ-ja nuk kishte detyrimin t'i informonte Krasniqin dhe Selimin për të drejtën e

---

<sup>114</sup> Aktgjykimi i Apelit *Gucati dhe Haradinaj*, para. 29.

<sup>115</sup> Shih Apelin e Krasniqit, para. 7-15; Apelin e Selimit, para. 7-9.

<sup>116</sup> Apeli i Selimit, para. 10; Kundërpërgjigja e Selimit, para. 3. Shih gjithashtu Përgjigjen Përmbledhëse të ZPS-së, para. 32.

<sup>117</sup> Shih më lart, para. 24.

<sup>118</sup> Paneli rikujton se në bazë të nenit 6 të KEDNJ-së, dhe siç përcaktohet, ndër të tjera, në nenin 38(3) të Ligjit dhe rregullat 42 deri 44 të Rregullores, personi i dyshuar (i) ka të drejtën të informohet për llojin dhe shkakun e akuzave të ngritura kundër tij ose saj brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që e kupton; (ii) ka të drejtën të informohet në lidhje me privilegjin e mosinkriminimit të vetes dhe të drejtën për të heshtur; dhe (iii) duhet t'i mundësohet ndihmë ligjore që nga momenti që ndaj tij ngrihet një akuzë penale. Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 17.

mosinkriminimit të vetes, pasi konsideroheshin si dëshmitarë e jo si të dyshuar.<sup>119</sup> Rrjedhimisht, nuk është e nevojshme që Paneli i Apelit të bëjë vlerësim nëse të akuzuarve nuk iu akorduan të gjitha ose disa prej garancive që u jepen personave të dyshuar në kohën kur dhanë provat e tyre për TPNJ-në dhe PSRK-në, për secilën deklaratë dhe/ose dëshmi të tyre të kontestuar në apel. Paneli rrëzon argumentet e Krasniqit dhe Selimit në lidhje me këtë aspekt.

40. Sidoqoftë, Paneli thekson se, për të arritur në përfundimin se është përmbushur elementi i parë i standardit të rregullës 138(2) të Rregullores, Trupit Gjykses i duhet ende të sigurojë që provat janë marrë në përputhje me garancitë minimale që i akordohen *dëshmitarit* sipas kornizave ligjore përkatëse dhe se dëshmitari nuk u detyrua në mënyrë të palejueshme të jepte dëshmi që mund të konsiderohet vetinkriminuese.

41. Në lidhje me garancitë mbrojtëse që u ofrohen dëshmitarëve sipas rregullës 90(E) të Rregullores së TPNJ-së,<sup>120</sup> Paneli vëren se në kohën kur Krasniqi dha dëshminë e majit 2007 në procesin gjyqësor të TPNJ-së dhe dëshminë e shkurtit 2005 në procesin gjyqësor të TPNJ-së, dhe Selimi dha dëshminë e majit 2005 në procesin gjyqësor të TPNJ-së, nuk duket se kontestohet se Krasniqi dhe Selimi nuk u informuan shprehimisht për procedurën e paraparë në rregullën 90(E) të Rregullores së TPNJ-së.<sup>121</sup> Në pamje të parë, dispozita nuk kërkon që dëshmitarët të informohen

---

<sup>119</sup> Paneli rikujton se garancitë sipas nenit 6 të KEDNJ-së bëhen të zbatueshme vetëm nga momenti kur dëshmitari konsiderohet i dyshuar ose nga momenti kur ai ose ajo duhej të ishte trajtuar si i dyshuar/e dyshuar. Shih më lart, para. 19-20.

<sup>120</sup> Në rregullën 90(E) të Rregullores së TPNJ-së thuhet: “Dëshmitari lejohet të refuzojë dhënien e çfarëdo deklarate prej së cilës mund të fajësohet. Gjithsesi, Dhoma mund ta detyrojë dëshmitarin që t’i përgjigjet pyetjes. Dëshmia e nxjerrë në këtë mënyrë nuk përdoret si provë në asnjë procedim penal të mëvonshëm të dëshmitarit për ndonjë shkelje, përveç rastit të dhënies së dëshmisë së rreme”.

<sup>121</sup> Shih Kundërpërgjigjen e Krasniqit, para. 4; Apelin e Selimit, para. 9. Në dallim nga kjo, Paneli i Apelit thekson se, sa i takon dëshmisë për PSRK-në të kundërshtuar në apel, Selimi u informua në bazë të neneve 125 dhe 129 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës të vitit 2012 (“KPPK-ja e vitit 2012”). Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 141, 144, 147, 150, 153.

paraprakisht.<sup>122</sup> Në dallim nga kjo, Paneli vëren se rregulla 151(1) e Rregullores, neni 129 i KPPK-së të vitit 2012 – që ishte në fuqi kur Selimi dha dëshmi për PSRK-në – si dhe neni 126 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës i vitit 2022, përmbajnë kriterin për informimin e dëshmitarëve mbi mundësinë që të refuzojnë të japin dëshmi vetinkriminuese.<sup>123</sup> Paneli është i mendimit se për të siguruar efektshmëri të plotë të garancive mbrojtëse të akorduara sipas rregullës 90(E) të Rregullores së TPNJ-së, do të kishte qenë e preferueshme që Krasniqi dhe Selimi të ishin informuar për këtë dispozitë para se të jepnin dëshmitë e tyre në TPNJ. Sidoqoftë, ata nuk kanë përmendur ndonjë rast kur, po të ishin informuar për këtë dispozitë, do të kishin kërkuar të zbatohet kjo rregull dhe do të kishin kundërshtuar të jepnin dëshmi për arsye se mund të inkriminonin veten. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit gjykon se mungesa e informimit paraprak, në vetvete, nuk përbën shkelje të të drejtave si dëshmitarë të të akuzuarve.

42. Sa i përket argumentit të Krasniqit se kombinimi i betimit solemn dhe urdhërparaqitjes cenoi dhënien vullnetarisht të dëshmisë prej tij,<sup>124</sup> Paneli i Apelit fillimisht rikujton se (i) privilegji i mosinkriminimit të vetes nuk mbron nga dhënia e deklaratës inkriminuese *per se*, por nga sigurimi i provave nëpërmjet shtrëngimit ose presionit,<sup>125</sup> dhe (ii) shkelja e nenit 6 të KEDNJ-së ndodh kur niveli i detyrimit në fjalë

<sup>122</sup> Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 159. Shih gjithashtu *Prlić et al.* Trial Chamber Decision, para. 18. Shih Apelin e Krasniqit, para. 12.

<sup>123</sup> Paneli i Apelit gjithashtu vë në dukje se rregulla 151(3) e Rregullores përcakton se “në qoftë se trupi gjykues vendos ta detyrojë dëshmitarin të dëshmojë, [...], trupi gjykues mund të përcaktojë se para dhënies së dëshmisë, dëshmitarit i duhet dhënë garanci në lidhje me vetinkriminimin [...]. Trupi gjykues e siguron dëshmitarin se dëshmia e dhënë në përgjigjet ndaj pyetjeve: [...] (b) nuk do të përdoret as drejtpërdrejt, as tërthorazi, kundër atij personi në një procedim penal të mëvonshëm në Dhomat e Specializuara, përveçse në bazë të nenit 15(2) të Ligjit dhe rregullës 65”.

<sup>124</sup> Shih Apelin e Krasniqit, para. 12-15.

<sup>125</sup> Shih *Ibrahim and Others* Judgment, para. 267. Shih gjithashtu IA024/F00019, Vendim në lidhje me Apelet e Mbrojtjes kundër Vendimit Kornizë për Trajtimin e Informacionit Konfidencial gjatë Hetimeve dhe Kontakteve ndërmjet një Pale ose Pjesëmarrësi dhe Dëshmitarëve të Palës ose Pjesëmarrësit Kundërshtar, 27 dhjetor 2022 (“Vendimi i Apelit në çështjen *Thaçi dhe të tjerët*”), para. 57.

shuan vetë thelbin e privilegjit të mosinkriminimit të vetvetes.<sup>126</sup> Në këtë aspekt, Paneli gjykon se fakti që një person bën betimin solemn për të thënë të vërtetën as përbën detyrim të palejueshëm dhe as e detyron personin të heqë dorë nga e drejta e mosinkriminimit të vetes.<sup>127</sup> Po kështu, në lidhje me urdhërparaqitjen, Paneli gjykon se ajo qartazi përmban njëfarë detyrimi pasi personi duhet të paraqitet para gjykatës nën kërcënimin e një sanksioni. Sidoqoftë, Paneli pajtohet me Trupin Gjykses se një person nuk është i detyruar të japë dëshmi vetinkriminuese për shkak të faktit se ka marrë urdhërparaqitje për të shkuar në gjykatë.<sup>128</sup> Mbi këtë bazë, Paneli konstaton se vetëm fakti se Krasniqi mori urdhërparaqitje për t'u paraqitur para TPNJ-së dhe iu desh të bëjë betimin solemn para se të jepte dëshmi, nuk përbën detyrim të palejueshëm për të dhënë dëshmi inkriminuese.<sup>129</sup>

43. Në vijim, Paneli do të përcaktojë nëse pranimi i provave të Krasniqit për TPNJ-në dhe provave të Selimit për TPNJ-në dhe PSRK-në, është në përputhje me të drejtën për gjykim të drejtë të garantuar me nenin 6 të KEDNJ-së – e përfshirë, ndër të tjera, në nenet 21 dhe 38(3) të Ligjit, rregullat 42 deri 44 të Rregullores dhe nenin 30 të

<sup>126</sup> Shih *Ibrahim and Others Judgment*, para. 267. Shih gjithashtu Vendimin e Gjykatës Kushtetuese për *Mahir Hasanin*, para. 33. Jurisprudenca e GJEDNJ-së evidenton tre lloje të situatave që përbëjnë shqetësim për detyrim të palejueshëm: (i) kur një i dyshuar detyrohet të dëshmojë nën kërcënimin e sanksioneve dhe, ose dëshmon për shkak të tyre, ose sanksionohet ngaqë refuzon të dëshmojë; (ii) kur ushtrohet presion fizik ose psikologjik, shpesh në formën e një trajtimi që shkel nenin 3 të KEDNJ-së, për të siguruar dëshmi ose deklarata reale; dhe (iii) kur autoritetet përdorin dredhi për të marrë informacione të cilat nuk kanë qenë në gjendje t'i marrin gjatë marrjes në pyetje. Shih *Ibrahim and Others Judgment*, para. 267. Shih gjithashtu Vendimin e Apelit në çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, poshtëshënimi 162.

<sup>127</sup> Shih ECtHR, *Serves v. France*, no. 82/1996/671/893, Judgment, 20 October 1997, para. 47 (ku GJEDNJ-ja u shpreh se “ndonëse detyrimi i dëshmitarit për të bërë betim dhe sanksionet që i vihen për mosbërjen e tij përbëjnë njëfarë shtrëngimi, ky i fundit ka për qëllim të sigurojë që deklaratat e dhëna para gjykatësit të jenë të vërteta, dhe jo për t'i detyruar dëshmitarët të japin dëshmi” dhe se pyetja së cilës duhet t'i jepej përgjigje ishte nëse “shtrëngimi ishte i tillë sa që e bëri të paefektshme të drejtën [e apellesit] për të mos inkriminuar veten”). Shih gjithashtu Vendimin e Kundërshtuar, para. 204.

<sup>128</sup> Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 200. Ndonëse marrja me detyrim e dëshmisë së një të akuzuari në procesin penal të tij është e ndaluar, nuk ka ndalim të përgjithshëm të mundësisë që një i akuzuar të detyrohet të dëshmojë në procese të tjera ku nuk konsiderohet i dyshuar. Shih ICTY, *Prosecutor v. Karadžić*, IT-95-5/18-AR73.11, Decision on Appeal Against the Decision on the Accused's Motion to Subpoena Zdravko Tolimir, 13 November 2013 (“*Karadžić Appeal Decision*”), para. 36.

<sup>129</sup> Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 200.

Kushtetutës – e drejtë që tani Krasniqit dhe Selimit u takon në cilësinë e të akuzuarve në këtë proces gjyqësor para Dhomave të Specializuara.<sup>130</sup>

44. Paneli i Apelit vë në dukje se në çështjen gjyqësore *Saunders*, që kishte të bënte me dëshminë e një dëshmitari marrë me detyrim në një hetim administrativ jopenal, e që më pas u përdor kundër tij kur u bë i akuzuar në një proces penal, GJEDNJ-ja vlerësoi se, ndonëse për atë hetim nuk ishin të zbatueshme garancitë për gjykim të drejtë sipas nenit 6 të KEDNJ-së, përdorimi i mëvonshëm i asaj dëshmie kundër apeluesit cenonte të drejtën e tij për të mos inkriminuar veten.<sup>131</sup> Në mënyrë të ngjashme, në çështjen gjyqësore *Lutsenko*, GJEDNJ-ja shqyrtoi nëse përdorimi i deponimit pranues të dëshmitarit në një proces penal të mëvonshëm kundër një personi tjetër, ishte në përputhje me kriteret e procesit të drejtë sipas nenit 6 të KEDNJ-së dhe konstatoi se kjo dëshmi, e marrë në mungesë të garancive procedurale, duhet të ishte trajtuar me “me kujdesin më të madh”.<sup>132</sup>

45. Së pari, Paneli i Apelit është i vetëdijshëm se jurisprudenca e GJEDNJ-së lidhet me përdorimin e provave dhe jo me pranimin e tyre.<sup>133</sup> Paneli nuk është në gjendje të vlerësojë se si do të përdoren provat Krasniqit për TPNJ-në dhe provat e Selimit për TPNJ-në dhe PSRK-në.<sup>134</sup> Megjithatë, duke pasur parasysh rolin e ndryshëm të Panelit

<sup>130</sup> Sa i përket dallimit që bëhet në parashtrimin e të akuzuarit mes dëshmisë dhe deklaratave, Paneli konstaton se lloji i provës në fjalë (qoftë dëshmi apo deklaratë) nuk ndikon në të drejtën e të akuzuarve për garancitë sipas nenit 6 të KEDNJ-së.

<sup>131</sup> *Saunders* Judgment, paras 60, 67, 69-70, 75-76.

<sup>132</sup> *Lutsenko* Judgment, paras 47, 50-53. GJEDNJ-ja gjykoi se “ndonëse aspekti i kontestuar në këtë çështje nuk është shpallja fajtor e autorit të [deponimit të marrë me detyrim], por ajo e të bashkakuzuarit të tij, Gjykata konstaton se parimet themelore janë përgjithësisht të ngjashme.” Shih *Lutsenko* Judgment, para. 51.

<sup>133</sup> Rregullat që përcaktojnë pranueshmërinë e provave kryesisht janë aspekte që rregullohen sipas legjislacionit të shteteve dhe, në parim, nuk është roli i GJEDNJ-së të vendosë nëse një lloj i caktuar provash mund të jetë i pranueshëm. Shih *Lutsenko* Judgment, para. 42 dhe referencat e cituara në të.

<sup>134</sup> Paneli vëren se në marrjen e vendimit nëse ishte shkelur neni 6 i KEDNJ-së, GJEDNJ-ja mori parasysh edhe nëse provat ishin përdorur “në masë vendimtare” në dënimin përkatës, duke kompromentuar kështu procesin në tërësi. Shih *Lutsenko* Judgment, paras 52-53. Shih gjithashtu *Kansal* Judgment, para. 29; *Ibrahim and Others* Judgment, para. 309; *Schmid-Laffer* Judgment, paras 39-40; *Saunders* Judgment, para. 72.

të Apelit krahasuar me atë të GJEDNJ-së,<sup>135</sup> Paneli i Apelit gjykon se jurisprudenca e GJEDNJ-së ka lidhje të drejtpërdrejtë me zbatimin e rregullës 138 të Rregullores,<sup>136</sup> për të përcaktuar nëse duhet të përjashtohen provat e Krasniqit për TPNJ-në dhe provat e Selimit për TPNJ-në dhe PSRK-në.<sup>137</sup>

46. Gjithashtu, në përputhje me këtë jurisprudencë të GJEDNJ-së, Paneli i Apelit thekson se dhomat gjyqësore të TPNJ-së shqyrtuan gjithashtu edhe situata të pranimit të dëshmive të dhëna nga dëshmitarë, të cilët më vonë u bënë të akuzuar para TPNJ-së, dhe kundër të cilëve prokuroria e TPNJ-së kërkoi të pranoheshin provat e marra më parë. Në këto raste, dhomat gjyqësore të TPNJ-së vlerësuan nëse të drejtat e të akuzuarve ishin mbrojtur mjaftueshëm në ato rrethana.<sup>138</sup>

47. Sipas Panelit, kjo jurisprudencë, në veçanti jurisprudenca e GJEDNJ-së, tregon se vendimi nëse të pranohen prova me gjasë vetinkriminuese të dhëna më parë nga

<sup>135</sup> Shih në mënyrë të ngjashme, Vendimin e Apelit *Shala*, para. 77.

<sup>136</sup> Paneli rikujton se rregulla 138 e Rregullores parasheh ndikimin e mundshëm të pranimit të provave në kontekstin e së të drejtës për gjykim të drejtë.

<sup>137</sup> Në kontekstin e Vendimit të Kundërshtuar, qëllimi i qartë i pranimit të provave të Krasniqit dhe Selimit është që ZPS-së t'i mundësohet t'i përdorë më vonë këto prova në lidhje me pretendimet kundër të akuzuarve. Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 140, 143, 146, 149, 152, 155, 158, 193, 199, 203 (ku përmenden pretendimet në lidhje me të cilat ZPS-ja synon të mbështetet në provat e Krasniqit për TPNJ-në dhe në provat e Selimit për TPNJ-në dhe PSRK-në).

<sup>138</sup> *Prlić et al.* Trial Chamber Decision, paras 13-16, 21-22 (ku Dhoma Gjyqësore e TPNJ-së refuzoi pranimin si prova të dëshmisë të Praljakut si dëshmitar, për arsye se të drejtat minimale të tij si i akuzuar, nuk ishin mbrojtur mjaftueshëm në kohën kur ai dha dëshminë, pasi nuk ishte informuar për të drejtën për të mos inkriminuar veten dhe mundësinë për të heshtur. Dhoma Gjyqësore konstatoi se nuk mund të supozonte se Praljaku kishte dijeni për këtë të drejtë dhe nuk kishte garancinë se ai hoqi dorë nga e drejta për të heshtur në kohën kur dha dëshminë); *Halilović* Trial Chamber Decision, para. 21 (ku Dhoma Gjyqësore e TPNJ-së arsyetoi se “për të mbrojtur të drejtën e të akuzuarit për gjykim të drejtë, në përputhje me nenin 21 të Statutit, duhet të merret parasysh a janë respektuar plotësisht garancitë mbrojtëse të rregullave 42, 43 dhe 63 të Rregullores kur u mor vendimi mbi pranimin e *çfarëdo* deklarate të mëhershme të një të akuzuari, pavarësisht prej statusit të të akuzuarit në momentin e marrjes së deklaratave”). Në atë rast, i akuzuari në fakt ishte informuar për të drejtat që kishte si i dyshuar para se të merrej në pyetje. Dhoma Gjyqësore e TPNJ-së në fund vendosi të mos e pranonte deklaratën e tij, por për arsye të tjera: meqenëse deklarata nuk ishte incizuar në audio apo video, Dhoma Gjyqësore nuk u bind se deklarata përfaqësonte “tërësisht dhe plotësisht ato që kishte thënë Sefer Halilović” dhe, rrjedhimisht, konstatoi se mbështetshmëria e saj ishte cenuar. Shih *Halilović* Trial Chamber Decision, paras 22, 24-26. Shih gjithashtu Apelin e Selimit, para. 27-28.

një dëshmitar, në mungesë të garancive të nenit 6, duhet të marrë parasysh të drejtën për të mos inkriminuar veten të cilën e gëzon *aktualisht* i akuzuari.

48. Megjithatë, në kundërshtim me çka pretendon Selimi, kjo nuk do të thotë se provat e dëshmitarëve nuk mund të pranohen nëse janë marrë në mungesë të garancive të nenit 6, apo se deklaratat e mëparshme të dëshmitarëve mund të përdoren kundër një të akuzuari vetëm nëse ai është informuar më parë për të drejtat dhe detyrimet e tij dhe i janë dhënë garancitë e nevojshme.<sup>139</sup> Sipas mendimit të Panelit, faktikisht ajo që kërkohet është vlerësimi i pasojave të pranimi të provave të marra në këto rrethana në kontekstin e së të drejtës kundër vetinkriminimit që tani personi e gëzon si i akuzuar. Gjithashtu, Paneli gjykon se jurisprudenca e GJEDNJ-së nuk përmban ndonjë ndalim të përgjithshëm për pranimin e një deklarate kundër një të akuzuari, që i është marrë personit si dëshmitar.

49. Paneli i Apelit tani do të trajtojë aspektin nëse Trupi Gjykses gabo i që konstatoi se kjo jurisprudencë e GJEDNJ-së dhe TPNJ-së është e pazbatueshme dhe/ose thelbësisht e dallueshme nga çështja aktuale.<sup>140</sup> Paneli vëren se Trupi Gjykses gjykoi se Vendimi i Dhomës Gjyqësore në çështjen *Halilović* dhe Vendimi i Dhomës Gjyqësore në çështjen *Përlić* nuk ishin precedentë të zbatueshëm në rrethanat aktuale, pasi provat në fjalë vinin nga i njëjti institucion të cilit iu kërkua t'i pranonte ato.<sup>141</sup> Sipas Trupit Gjykses, në këto raste, pala që paraqiti provat ishte në gjendje të garantonte të drejtat e personave në fjalë, pasi ishte përfshirë në mbledhjen dhe dorëzimin e atyre provave.<sup>142</sup> Paneli i Apelit vëren se Trupi Gjykses nuk dha ndonjë referencë në mbështetje të qëndrimit të tij dhe gjykon se ky qëndrim nuk mbështetet nga jurisprudenca e GJEDNJ-së.<sup>143</sup> Për të njëjtat arsye, Paneli i Apelit rrëzon

---

<sup>139</sup> Shih Apelin e Selimit, para. 11, 31-33, 41.

<sup>140</sup> Shih Përgjigjen Përmblidhëse të ZPS-së, para. 40; Vendimin e Kundërshtuar, para. 160.

<sup>141</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 160.

<sup>142</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 160.

<sup>143</sup> Shih në lidhje me këtë, *Delalić et al.* Trial Chamber Decision, paras 22-23, 43.

pretendimin e ZPS-së se jurisprudenca në çështjet gjyqësore *Saunders* dhe *Lutsenko* në GJEDNJ, dallon nga ajo e çështjes aktuale, për arsye se kishte të bënte me prova që kërkoj t'i përdorte i njëjti autoritet që i kishte marrë me detyrim ato.<sup>144</sup> Sipas mendimit të Panelit të Apelit, pavarësisht se bëhej fjalë për të njëjtat autoritete,<sup>145</sup> kjo jurisprudencë e GJEDNJ-së është plotësisht relevante dhe e zbatueshme për çështjen aktuale, pasi fakti që provat e kundërshtuara në apel u mbledhën në një juridiksion dhe më vonë u përdorën nga një juridiksion tjetër, nuk duhet të ketë ndikim në të drejtat e të akuzuarit.

50. Gjithashtu, në lidhje me aspektin nëse çështjet janë thelbësisht të dallueshme, Paneli i Apelit vëren se Trupi Gjyqësor vlerësoi se rrethanat e çështjes gjyqësore *Halilović* ishin të ndryshme, pasi prova në fjalë ishte marrë pasi *Halilović* ishte vënë nën akuzë nga TPNJ-ja.<sup>146</sup> Në arsyetimin e tij për rrëzimin e parashtrimeve të Mbrojtjes, Trupi Gjyqësor nuk trajtoi Vendimin e Dhomës Gjyqësore në çështjen *Halilović*, në të cilin mbështetet Selimi dhe pjesa relevante e të cilit u konfirmua nga Dhoma e Apelit e TPNJ-së.<sup>147</sup> Paneli i Apelit vëren se, në kundërshtim me konstatimin e Trupit Gjyqësor,<sup>148</sup> *Halilović* nuk ishte i dyshuar kur prokuroria e TPNJ-së mori provën për të cilën bëhet fjalë në këtë vendim.<sup>149</sup> Rrjedhimisht, Paneli i Apelit pajtohet me Mbrojtjen se Trupi Gjyqësor e anashkaloi këtë vendim relevant kur konstatoi se

---

<sup>144</sup> Shih Përgjigjen Përmbledhës të ZPS-së, para. 14, 16, 35, 40.

<sup>145</sup> Shih Kundërpërgjigjen e Krasniqit, para. 8; Kundërpërgjigjen e Selimit, para. 13.

<sup>146</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 160.

<sup>147</sup> ICTY, *Prosecutor v. Halilović*, IT-01-48-A, Judgement, 16 October 2007, para. 36.

<sup>148</sup> Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 160. Paneli i Apelit thekson se gjatë bërjes së këtij konstatimi, duket se Trupi Gjyqësor është mbështetur gabimisht në një vendim tjetër në çështjen *Halilović*, kur *Halilović* tashmë ishte vënë nën akuzë, dhe të cilit Krasniqi i është referuar në parashtrimet e tij për Trupin Gjyqësor. *Krahaso*, poshtëshënimet 456-457 të Vendimit të Kundërshtuar dhe paragrafin 25, poshtëshënimin 52 të Përgjigjes së Krasniqit, ku të dyja i referohen çështjes së TPNJ-së, *Prosecutor v. Halilović*, IT-01-48-AR73.2, Decision on Interlocutory Appeal Concerning Admission of Record of Interview of the Accused from the Bar Table, 19 August 2005 me poshtëshënimin 456 të Vendimit të Kundërshtuar dhe paragrafin 50, poshtëshënimin 45 të Përgjigjes së Selimit, ku të dyja i referohen *Halilović* Trial Chamber Decision.

<sup>149</sup> *Halilović* Trial Chamber Decision, para. 21. Shih gjithashtu Apelin e Selimit, para. 39-40.

çështja gjyqësore *Halilović* dallonte nga rrethanat e çështjes aktuale, sepse kishte të bënte me një të dyshuar e jo me një dëshmitar.<sup>150</sup>

51. Paneli tani do të vlerësojë nëse vendimi i Trupit Gjyqësor për pranimin e provave të Krasniqit për TPNJ-në dhe provave të Selimit për TPNJ-në dhe PSRK-në, ishte në përputhje me parimin e përcaktuar më lart, konkretisht me nevojën për të vlerësuar nëse pranimi i këtyre provave të marra në mungesë të dhënies së garancive të nenit 6, cenon të drejtën e të akuzuarve për të mos inkriminuar veten, të cilën e kanë aktualisht.<sup>151</sup> Paneli rikujton se kur mori vendimin për pranimin e provave të Krasniqit për TPNJ-në dhe provave të Selimit për TPNJ-në dhe PSRK-në, Trupi Gjyqësor konstatoi në mënyrë të përsëritur se “për pranimin si provë në një proces gjyqësor të mëvonshëm të deklaratës që një person e ka dhënë si dëshmitar, zakonisht nuk është e nevojshme që atij t’i bëhen të gjitha paralajmërimet që i bëhen një të dyshuari”.<sup>152</sup> Sipas mendimit të Panelit, ky konstatim përbën keqinterpretim të standardeve ligjore përkatëse të përcaktuara nga GJEDNJ-ja. Ndonëse, siç u konstatua më lart,<sup>153</sup> nuk kërkohet që dëshmitarit t’i bëhen këto paralajmërimet në kohën kur jep dëshminë, pranimi i kësaj prove në procese të mëvonshme mund të cenojë të drejtën e të akuzuarit për të mos inkriminuar veten, pikërisht për shkak të rrethanave në të cilat u mor dëshmia, kur këto paralajmërimet nuk ishin të zbatueshme.<sup>154</sup>

52. Paneli vëren se bazuar në rregullën 138(1) të Rregullores, Trupi Gjyqësor konstatoi se vlera provuese e provave në fjalë nuk zhbëhej prej efektit dëmtues të tyre, për arsye se “Mbrotjtja do të ketë mundësinë të paraqesë prova për t’i kundërshtuar”.<sup>155</sup>

---

<sup>150</sup> Shih Apelin e Selimit, para. 40. Shih Përgjigjen Përmbledhës të ZPS-së, para. 40. Sidoqoftë, Paneli rikujton se Dhoma Gjyqësore e TPNJ-së vendosi të mos e pranojë deklaratën e Halilovićit për arsye të tjera, konkretisht se asaj i mungonte mbështetshmëria pasi nuk ishte audioincizuar ose videoincizuar. Shih *Halilović* Trial Chamber Decision, para. 22, 24-26. Shih gjithashtu poshtëshënimin 138 më lart.

<sup>151</sup> Shih më lart, para. 44-47.

<sup>152</sup> Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 141, 144, 147, 150, 153, 156, 159, 194, 200, 204.

<sup>153</sup> Shih më lart, para. 39.

<sup>154</sup> Shih më lart, para. 44, 47.

<sup>155</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 141, 144, 147, 150, 153, 156, 161, 196, 200, 204.

Sa i përket rregullës 138(2) të Rregullores, Trupi Gjykses e kufizoi vlerësimin e tij te aspekti nëse provat ishin dhënë vullnetarisht dhe pa shtrëngim dhe detyrim të palejueshëm.<sup>156</sup> Paneli i Apelit vëren se Trupi Gjykses nuk shqyrtoi ndikimin e faktit që në atë kohë garancitë e nenit 6 nuk ishin të zbatueshme mbi të drejtën për të mos inkriminuar veten, të cilën Krasniqi dhe Selimi e gëzojnë aktualisht si të akuzuar para Dhomave të Specializuara, dhe nëse pranimi i këtyre provave mund ta shkelë këtë të drejtë.

53. Ndonëse mban parasysh diskrecionin e gjerë që ka Trupi Gjykses në marrjen e vendimeve për pranimin ose jo të provave,<sup>157</sup> Paneli i Apelit është i mendimit se Trupi Gjykses duhet të kishte vlerësuar nëse pranimi, kundër një të akuzuari, i provave me gjasë vetinkriminuese të marra më parë prej tij si dëshmitar në mungesë të garancive të nenit 6, tani shkel të drejtën e tij për të mos inkriminuar veten, dhe rrjedhimisht përbën shkelje të standardeve të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në kuadër të rregullës 138(2) të Rregullores. Sipas Panelit, duke mos e kryer këtë vlerësim, Trupi Gjykses kreu një gabim të dallueshëm pasi nuk zbatoi standardin e saktë juridik për pranimin, kundër një të akuzuari, të provave me gjasë vetinkriminuese të marra më parë prej tij si dëshmitar. Ndikimi, nëse ka, i këtij konstatimi për gabimi, do të vlerësohet më poshtë.<sup>158</sup>

54. Së fundi, në lidhje me fushëveprimin e zbatimit të rregullës 90(E) të Rregullores së TPNJ-së,<sup>159</sup> Paneli nuk sheh asnjë gabim në konstatimin e Trupit Gjykses se kjo dispozitë nuk kishte zbatim dhe as nuk synohej të kishte zbatim jashtë juridiksionit të

---

<sup>156</sup> Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 141, 144, 147, 150, 153, 156, 161, 194, 200, 204.

<sup>157</sup> Shih më lart, para. 6.

<sup>158</sup> Shih më poshtë, para. 55.

<sup>159</sup> Në kundërshtim me atë që pretendon ZPS-ja, Paneli nuk konstaton se ky argument del jashtë kuadrit të pikave të autorizuara për apel. Shih Përgjigjen Përmbledhëse të ZPS-së, para. 34; Kundërpërgjigjen e Selimit, para. 9-10. Paneli thekson se pika e katërt e Selimit, për të cilën leja për apel u refuzua, kishte të bënte me efektin dëmtues të shkaktuar nga pranimi i provave. Shih Vendimin për Lejen për Apel, para. 8(4), 78-82.

TPNJ-së.<sup>160</sup> Paneli gjithashtu vë në dukje se Mbrojtja nuk kundërshton se rregulla 90(E) e Rregullores së TPNJ-së nuk zbatohet në Dhomat e Specializuara.<sup>161</sup> Paneli i Apelit vëren se, sa i përket TPNJ-së, kornizat ligjore të Dhomave të Specializuara dhe Gjykatës Penale Ndërkombëtare ("GJPN"), përmbajnë dispozita të ngjashme që parashikojnë imunitet nga ndjekja penale dhe ndalimin e përgjithshëm të përdorimit të mëposhëm të provave të dëshmitarëve që merren me detyrim në atë mënyrë, domethënë, kur dëshmitarit i kërkohet nga dhoma gjyqësore që t'u përgjigjet pyetjeve të cilat mund ta inkriminojnë.<sup>162</sup> Sidoqoftë, ky apel nuk ka të bëjë me një situatë e tillë,<sup>163</sup> sepse zbatimi i rregullës 90(E) të Rregullores së TPNJ-së nuk u aktivizua asnjëherë në kontekstin e dëshmimeve të Krasniqit dhe Selimit në TPNJ, sepse asnjë prej të akuzuarve nuk refuzoi të jepte dëshmi për arsye të shqetësimeve për vetinkriminim të mundshëm kur u detyrua nga dhoma gjyqësore ta jepte dëshminë.<sup>164</sup>

55. Paneli i Apelit tani do të trajtojë ndikimin e konstatimit të gabimit në Vendimin e Kundërshtuar në lidhje me vlerësimin e Trupit Gjykses për pranueshmërinë e provave sipas rregullës 138(2) të Rregullores.<sup>165</sup> Ndonëse Trupi Gjykses nuk bëri vlerësim të ndikimit të pranimi të provave të Krasniqit për TPNJ-në dhe provave të Selimit për TPNJ-në dhe PSRK-në mbi të drejtën e të akuzuarve për të mos inkriminuar veten, të cilën tani e kanë, Paneli i Apelit fillimisht vë në dukje se në dëshmitë e tyre, Krasniqi dhe Selimi nuk evidentojnë ndonjë rast kur, sipas tyre, do të duhej të ishte aktivizuar e drejta për të mos inkriminuar veten dhe/ose ndonjë rast kur

<sup>160</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 159.

<sup>161</sup> Shih Apelin e Krasniqit, para. 24; Apelin e Selimit, para. 23.

<sup>162</sup> Shih rregullën 151(3)(b) të Rregullores; rregullën 74(3) të Rregullores së GJPN-së. Shih gjithashtu *Karadžić Appeal Decision*, paras 41-45. Shih në mënyrë të ngjashme, *Kansal Judgment*, paras 27-29.

<sup>163</sup> Në rast të një skenari të tillë, Panelet do ta konsideronin shumë shqetësuese, sa i takon efektshmërisë së garancive të GJEDNJ-së, nëse imuniteti nga ndjekja penale i garantuar sipas këtyre dispozitave në lidhje me provat e marra me detyrim në këto rrethana nuk do të ofrohej më, vetëm për arsye se ato do të pranoheshin dhe përdreshin në procese penale para një juridiksioni tjetër. Sipas Panelit, edhe pse këto dispozita nuk janë as të zbatueshme e as të detyrueshme për Dhomat e Specializuara, gjykatësit duhet t'i kenë parasysh këto aspekte kur marrin vendimin për të pranuar ose jo provat dhe/ose për t'u mbështetur në prova që vijnë nga një juridiksion tjetër e që merren me detyrim në atë mënyrë.

<sup>164</sup> Shih më lart, para. 41.

<sup>165</sup> Shih nenin 46(4) të Ligjit; Vendimin e Apelit *Gucati*, para. 7, 10.

ata u pyetën për përfshirjen e drejtpërdrejtë të tyre në kryerjen e krimeve për të cilat aktualisht akuzohen. Paneli gjithashtu vëren se në asnjë rast të akuzuarit nuk refuzuan të jepnin dëshmi për shkak të shqetësimeve për vetinkriminimin e mundshëm të tyre. Pasi shqyrtoi me kujdes provat e Krasniqit për TPNJ-në dhe provat e Selimit për TPNJ-në dhe PSRK-në dhe vlerësoi nëse ato duhet të përjashtoheshin për shkak të ndikimit të tyre në të drejtën e të akuzuarve për të mos inkriminuar veten, Paneli i Apelit nuk është bindur se pranimi i këtyre provave, në vetvete, përbën shkelje të së drejtës së Krasniqit dhe Selimit për të mos inkriminuar veten. Gjithashtu, ndonëse i vetëdijshëm se duhet treguar kujdes kur të vendoset se çfarë peshe do t'u jepet këtyre provave,<sup>166</sup> nëse do t'u jepet peshë, Paneli i Apelit vlerëson se Trupi Gjykses, i përbërë nga gjykatës profesionistë dhe me përvojë, pritët t'i përdorë provat me kujdesin e duhur.

56. Bazuar në sa më lart, Paneli arrin në përfundimin se gabimi i Trupit Gjykses nuk zhvlerëson konstatimin e përgjithshëm se provat e Krasniqit për TPNJ-në dhe provat e Selimit për TPNJ-në dhe PSRK-në, nuk duhet të përjashtohen dhe nuk ndikojnë në rezultatin e Vendimit të Kundërshtuar. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzon Pikën e Parë të Krasniqit dhe Pikën e Tretë të Selimit.

C. NËSE TRUPI GJYKUES GABOI QË PRANOI SI PROVA DEKLARATAT E TË BASHKAKUZUARVE TË KRASNIQIT (PIKA E NËNTË E KRASNIQIT)

### 1. Parashtrimet e palëve

57. Krasniqi argumenton se pranimi prej Trupit Gjykses i deklaratave të të bashkakuzuarve të tij, i shkel atij të drejtën për t'u ballafaquar me provat kundër tij, sipas nenit 21(4)(f) të Ligjit.<sup>167</sup> Ai argumenton se, duke qenë se të bashkakuzuarit e tij nuk janë dëshmitarë të ZPS-së, nuk është e nevojshme që ata të japin dëshmi apo t'u bëhen pyetje nga pala jothirrëse.<sup>168</sup> Sipas Krasniqit, gjykata dhe tribunale të tjerë

<sup>166</sup> Shih *Lutsenko* Judgment, para. 51. Shih gjithashtu Vendimin e Kundërshtuar, para. 218-219.

<sup>167</sup> Apeli i Krasniqit, para. 39-40, 45, 51. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen e Krasniqit, para. 2.

<sup>168</sup> Apeli i Krasniqit, para. 40.

ndërkombëtarë kanë përjashtuar deklaratat e mëhershme të të bashkakuzuarve mbi këtë bazë.<sup>169</sup>

58. Krasniqi gjithashtu argumenton se Trupi Gjykses, pasi konstatoi mungesën e ndonjë rregulle tjetër specifike në lidhje me pranimin e deklaratave të mëhershme të të bashkakuzuarve, gaboi që zbatoi rregullën 138(1) të Rregullores.<sup>170</sup> Sipas Krasniqit, duke pasur parasysh se rregullat 141, 153 dhe 155 të Rregullores nuk janë të zbatueshme pasi të bashkakuzuarit nuk janë dëshmitarë të ZPS-së apo të padisponueshëm, dhe deklaratat janë për vërtetimin e veprimeve dhe sjelljes së Krasniqit, deklaratat e dhëna më herët prej të bashkakuzuarve duhet të përjashtohen.<sup>171</sup> Krasniqi gjithashtu pretendon se Trupi Gjykses gaboi që nuk mori parasysh nenin 55 të Kushtetutës, në të cilin thuhet se të drejtat themelore “mund të kufizohen vetëm me ligj” dhe se, para se të kufizonte të drejtën e Krasniqit për t’u ballafaquar me provat kundër tij, që Trupi Gjykses duhej të kishte vlerësuar proporcionalitetin dhe “t’i kushtonte vëmendje të veçantë thelbit të së drejtës së kufizuar”.<sup>172</sup>

59. Si alternativë, Krasniqi parashtrohet se, edhe nëse Trupi Gjykses e zbatoi saktë rregullën 138(1) të Rregullores, ai gaboi në vlerësimin e aspektit nëse vlera provuese e deklaratave të mëhershme të të bashkakuzuarve ishte zhbërë prej efektit dëmtues të tyre.<sup>173</sup> Së pari, ai argumenton se Trupi Gjykses nuk mori parasysh se ato deklarata janë të tilla që në to nuk mund të mbështetesh për shkak të mospërputhjeve të brendshme dhe/ose mënyrës në të cilën u mor informacioni.<sup>174</sup> Së dyti, Krasniqi parashtrohet se Trupi Gjykses gaboi që u mbështet në faktin se të bashkakuzuarit i dhanë dëshmitë e tyre vullnetarisht, pasi kjo nuk jep zgjidhje për pamundësinë e

---

<sup>169</sup> Apeli i Krasniqit, para. 40.

<sup>170</sup> Apeli i Krasniqit, para. 42. Shih gjithashtu Apelin e Krasniqit, para. 44.

<sup>171</sup> Apeli i Krasniqit, para. 41-43.

<sup>172</sup> Apeli i Krasniqit, para. 45. Shih gjithashtu Apelin e Krasniqit, para. 40.

<sup>173</sup> Apeli i Krasniqit, para. 46. Shih gjithashtu Apelin e Krasniqit, para. 51.

<sup>174</sup> Apeli i Krasniqit, para. 47.

Krasniqit për t'u ballafaquar me informacionin.<sup>175</sup> Së fundi, Krasniqi parashtron se Trupi Gjykses nuk vlerësoi si duhet dëmin që i shkaktonte Krasniqit pranimi si prova i deklaratave, veçanërisht nëse ai nuk mund t'u bëjë pyetje të bashkakuzurve dhe nuk ka informacion konkret nga ZPS-ja për mënyrën se si do të përdoren deklaratat.<sup>176</sup>

60. ZPS-ja përgjigjet së pari se argumenti i Krasniqit se Trupi Gjykses gaboi që u mbështet në rregullën 138(1) të Rregullores, është i pabazë, pasi në vend që të citonte ndonjë rregull alternative relevante, ai përmend rregulla të përgjithshme që nuk janë të zbatueshme për provat në fjalë.<sup>177</sup> ZPS-ja gjithashtu pretendon se Krasniqi keqinterpretonte se neni 55 i Kushtetutës presupozon "të drejtën për t'u bërë pyetje dëshmitarëve kundër tij" dhe se pranimi i provave me shkrim e kufizon këtë të drejtë, që demonstron nga "vetë rregullat e cituara prej tij".<sup>178</sup>

61. Në lidhje me argumentin e Krasniqit se Trupi Gjykses bëri një numër gabimesh në zbatimin e rregullës 138(1) të Rregullores, ZPS-ja së pari argumenton se Trupi Gjykses mori specifikisht parasysh se, ndonëse dhomat kanë njëfarë diskrecioni për të vendosur për pranimin e deklaratave të një të bashkakuzuari kur kjo do të shkaktonte dëm të palejueshëm, në çështjen aktuale, Trupi Gjykses vlerësoi faktorët e autenticitetit dhe mbështetshmërisë dhe ushtroi diskrecionin e tij për t'i pranuar deklaratat, pasi peshoi vlerën provuese të tyre kundrejt efektit dëmtues.<sup>179</sup> Gjithashtu, ZPS-ja argumenton se, kur Trupi Gjykses vlerësoi autenticitetin dhe vlerën provuese

---

<sup>175</sup> Apeli i Krasniqit, para. 48.

<sup>176</sup> Apeli i Krasniqit, para. 49-50.

<sup>177</sup> Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 24. Shih Përgjigjen Përmbledhëse të ZPS-së, para. 30. ZPS-ja parashtron se Trupi Gjykses analizoi posaçërisht nëse në Kushtetutë, Ligj ose Rregullore trajtohej pranueshmëria e deklaratave të bashkakuzuarve dhe, pasi nuk gjeti ndonjë dispozitë konkrete të zbatueshme, u mbështet në parimet e përgjithshme të pranimin të provave para Dhomave të Specializuara. Shih Përgjigjen Përmbledhëse të ZPS-së, para. 24.

<sup>178</sup> Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 24, poshtëshënimi 55, që u referohet rregullave 153 dhe 155 të Rregullores, të cilat, sipas ZPS-së, lejojnë pranimin e provave me shkrim pa pyetje nga pala kundërshtare.

<sup>179</sup> Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 25. Shih gjithashtu Përgjigjen Përmbledhëse të ZPS-së, para. 30.

si faktorë për pranim sipas rregullës 138(1) të Rregullores, ai faktikisht e mori parasysh faktin se deklaratat e të bashkakuzuarve ishin dhënë vullnetarisht.<sup>180</sup>

62. ZPS-ja gjithashtu parashtroi se gjykatat penale ndërkombëtare kanë konstatuar se pranimi i deklaratave të të bashkakuzuarve nuk shkel të drejtën për gjykim të drejtë të një të akuzuari, kur vlera provuese e deklaratave nuk zhbëhet prej ndonjë efekti dëmtues të mundshëm dhe, së dyti, sipas GJEDNJ-së, nuk ka ndonjë pengesë *per se* për pranimin ose përdorimin e tyre, me kusht që të plotësohen disa kriterë.<sup>181</sup>

63. Gjithashtu, sipas ZPS-së, e drejta e Krasniqit për të verifikuar provat kundër tij nuk kufizohet vetëm te pyetjet dhe – siç konfirmohet nga Trupi Gjykses – edhe nëse disa prej të bashkakuzuarve të tij vendosin të mos japin dëshmi, ai prapë mund t'i kundërshtojë provat përmes dëshmitarëve ose provave të tjera.<sup>182</sup> Së fundi, ZPS-ja argumenton se Trupi Gjykses ka në dispozicion garanci mbrojtëse të tjera për të kufizuar efektin dëmtues të mundshëm të këtyre provave dhe për të siguruar që atyre t'u jepet pesha e duhur në fund të procesit, duke marrë parasysh të gjitha provat e paraqitura në gjykim, dhe veçanërisht, provat konfirmuese.<sup>183</sup>

## 2. Vlerësimi i Panelit të Gjykatës së Apelit

64. Paneli i Apelit vëren se Trupi Gjykses konstatoi se nuk kishte një dispozitë konkrete në Kushtetutë, Ligji apo Rregullore që trajton pranueshmërinë e deklaratave të të bashkakuzuarve si prova.<sup>184</sup> Pasi përcaktoi se deklaratat e të akuzuarve dhe provat materiale shoqëruese të tyre ishin të pranueshme në bazë të rregullës 138(1) të Rregullores, Trupi Gjykses konstatoi se pranimi i tyre “*në vetvete*, nuk dëmton të

---

<sup>180</sup> Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 26.

<sup>181</sup> Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 28.

<sup>182</sup> Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 27, 29.

<sup>183</sup> Përgjigjja Përmbledhëse e ZPS-së, para. 27, 29.

<sup>184</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 215.

akuzuarit apo të bashkakuzuarit” dhe se nuk kishte pengesë për pranimin e tyre kundër katër të akuzuarve.<sup>185</sup>

65. Fillimisht, Paneli i Apelit do të trajtojë argumentin e Krasniqit se Trupi Gjykses gaboi që u mbështet në rregullën 138(1) të Rregullores – një “rregull e përgjithshme që ka të bëjë me diskrecionin” – për të pranuar deklaratat e të bashkakuzuarve.<sup>186</sup> Paneli i Apelit vë në dukje se vetë Krasniqi pranon se asnjë prej rregullave të tjera që mund të zbatohen – konkretisht, rregullat 141, 153 dhe 155 të Rregullores – nuk janë relevante për pranimin e deklaratave të mëhershme të të bashkakuzuarve.<sup>187</sup> Paneli i Apelit gjykon se, në mungesë të një dispozite specifike në kornizën ligjore të Dhomave të Specializuara, Trupi Gjykses zbatoi dispozitën e duhur që rregullon pranueshmërinë e provave në përgjithësi.<sup>188</sup> Gjithashtu, Paneli i Apelit thekson se Trupi Gjykses pranoi kufizimet për pranimin e deklaratave të të bashkakuzuarve sipas rregullës 138 të Rregullores, konkretisht se konstatimet mbi fajësinë e të akuzuarit “nuk mund të bazohen vetëm, ose në masë vendimtare, në deklarata të tilla”.<sup>189</sup> Rrjedhimisht, Paneli i Apelit nuk konstaton gabim në zbatimin prej Trupit Gjykses të rregullës 138(1) të Rregullores në marrjen e vendimit mbi pranueshmërinë si prova të deklaratave të të bashkakuzuarve kundër të akuzuarit.

66. Në vijim, Paneli do të shqyrtojë argumentin e Krasniqit se Trupi Gjykses nuk trajtoi nenin 55 të Kushtetutës dhe kufizimin e të drejtës së tij për të verifikuar provat kundër tij. Paneli thekson se çdo vlerësim në bazë të nenit 55 të Kushtetutës<sup>190</sup> është i ngjashëm me atë të kryer nga GJEDNJ-ja kur vlerëson shkeljen e një të drejte të garantuar nga KEDNJ-ja, dhe me vlerësimin e kryer nga Trupi Gjykses në paragrafin

---

<sup>185</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 217, 219.

<sup>186</sup> Shih Apelin e Krasniqit, para. 42-45.

<sup>187</sup> Shih Apelin e Krasniqit, para. 42-44.

<sup>188</sup> Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 215.

<sup>189</sup> Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 215, 218.

<sup>190</sup> Paneli rikujton se, në bazë të nenit 31(4) të Kushtetutës, nenit 6(3) të KEDNJ-së dhe nenit 21(4)(f) të Ligjit, i akuzuari ka të drejtën themelore për t’u bërë pyetje dëshmitarëve dhe për të verifikuar provat kundër tij.

218 të Vendimit të Kundërshtuar.<sup>191</sup> Rrjedhimisht, Paneli i Apelit konstaton se Krasniqi nuk ka demonstruar se Trupi Gjykses gaboi që nuk trajtoi në mënyrë specifike nenin 55 të Kushtetutës në vendimin mbi pranimin si prova të deklaratave të të bashkakuzuarve.

67. Paneli i Apelit vëren se GJEDNJ-ja është shprehur se nuk ka një pengesë *per se* për pranimin ose përdorimin e deklaratave të mëhershme të të bashkakuzuarve, me kusht që ato të plotësojnë kritere specifike.<sup>192</sup> Këto kritere janë që deklaratat duhet të jenë marrë në mënyrë të ligjshme, i akuzuari duhet të ketë pasur mundësi të kundërshtojë deklaratat, dhe shpallja fajtor e një të bashkakuzuari nuk duhet të bazohet në një masë “vendimtare” në to.<sup>193</sup>

68. Paneli i Apelit gjithashtu vë në dukje se jurisprudenca e gjykatave dhe tribunaleve ndërkombëtarë përrputhet me konstatimin e Trupit Gjykses se pranimi i deklaratës së të bashkakuzuarit nuk cenon të drejtën për gjykim të drejtë të të akuzuarit, sa kohë që vlera provuese e deklaratës nuk zhbëhet prej efektit dëmtues që mund të sjellë pranimi i saj.<sup>194</sup> Gjithsesi, Paneli thekson se është në diskrecionin e panelit të shkallës më të ulët që të refuzojë pranimin e deklaratës së një të

<sup>191</sup> Shih më poshtë, para. 72. Paneli gjithashtu vë në dukje se GJEDNJ-ja konstatoi se refuzimi i të bashkakuzuarve për të dhënë dëshmi mbi bazën e së drejtës për të mos inkriminuar veten mund të jetë arsye e vlefshme që gjykata të pranojë si prova deklaratat e një dëshmitari që nuk pyetet në gjykim. Shih ECtHR, *Strassenmeyer v. Germany*, no. 57818/18, Judgment, 2 May 2023, paras 73-74; ECtHR, *Vidgen v. The Netherlands*, no. 29353/06, Judgment, 10 July 2012, para. 42.

<sup>192</sup> Shih p.sh. ECtHR, *Lucà v. Italy*, no. 33354/96, Judgment, 27 February 2001 (“*Lucà Judgment*”), paras 40-41.

<sup>193</sup> *Lucà Judgment*, paras 40-41; ECtHR, *Al-Khawaja and Tahery v. The United Kingdom*, nos 26766/05 dhe 22228/06, Judgment, 15 December 2011 (“*Al-Khawaja and Tahery Judgment*”), paras 126-147. Shih gjithashtu ECtHR, *Seton v. The United Kingdom*, no. 55287/10, Judgment, 31 March 2016, para. 58.

<sup>194</sup> Shih p.sh. ICTY, *Prosecutor v. Prlić et al.*, IT-04-74-AR73.6, Decision on Appeals Against Decision Admitting Transcript of Jadranko Prlić’s Questioning Into Evidence, 23 November 2007 (“*Prlić et al. Appeal Decision*”), para. 62, ku Dhoma e Apelit e TPNJ-së konstatoi se “duke pasur parasysh balancimin e kujdesshëm të kryer prej saj mes vlerës provuese të [...] transkriptit dhe efektit dëmtues të mundshëm për të bashkakuzuarit prej pranimin të tij, [Dhoma Gjyqësore] nuk e ka keqinterpretuar ose zbatuar në mënyrë të gabuar ligjin në fuqi” kur e pranoi atë. Shih gjithashtu Vendimin e Kundërshtuar, para. 216.

bashkakuzuari kur efekti dëmtues i shkaktuar zhbën vlerën provuese të deklaratës në fjalë.<sup>195</sup>

69. Në lidhje me këtë, Paneli i Apelit gjykon se ky balancim i kujdesshëm duhet të bëhet nga Trupi Gjykes gjatë peshimit të vlerës provuese dhe efekteve dëmtuese, në kuadër të vendimit për pranimin ose jo të deklaratës së një të bashkakuzuari, duke marrë parasysh edhe rrethanat konkrete të çështjes.<sup>196</sup>

70. Duke qenë se Paneli i Apelit nuk konstaton gabim në pranimin e deklaratave dhe provave materiale shoqëruese të të akuzuarve kundër të bashkakuzuarit,<sup>197</sup> ai gjykon se, në fund, kjo ka të bëjë me sa peshë duhet t'u jepet atyre, nëse do t'u jepet peshë. Paneli i Apelit konstaton se vendimi për këtë mund të merret vetëm nga Trupi Gjykes në fund të gjykimit, bazuar në të gjitha provat relevante të paraqitura.

71. Lidhur me aspektin nëse i akuzuari do të ketë mundësinë të ballafaqohet me të bashkakuzuarit në këtë çështje gjyqësore, Paneli i Apelit thekson se Trupi Gjykes u shpreh se “i akuzuari mund të zgjedhë të mos dëshmojë dhe nuk mund të detyrohet ta bëjë këtë sipas kornizës ligjore [të Dhomave të Specializuara]”, dhe se, për këtë arsye, ishte i vetëdijshëm se të bashkakuzuarit “mund të mos ishin në gjendje të verifikonin plotësisht përmbajtjen e deklaratave të dhëna nga të bashkëpandehurit”.<sup>198</sup> Paneli i Apelit gjithashtu vëren se Trupi Gjykes konstatoi se, në këtë rast, “kërkohet

---

<sup>195</sup> *Prlić et al.* Appeal Decision, para. 62; ICC, *Prosecutor v. Katanga and Ngudjolo Chui*, ICC-01/04-01/07-2635, Decision on the Prosecutor's Bar Table Motions, 17 December 2010, para. 53. Shih gjithashtu Vendimin e Kundërshtuar, para. 217.

<sup>196</sup> *Prlić et al.* Appeal Decision, para. 62. Shih gjithashtu më lart, para. 6. Paneli i Apelit rikujton se Trupi Gjykes (i) ka diskrecion të gjerë për të vlerësuar peshën e saktë që i duhet dhënë dëshmisë së dëshmitarit dhe provave të pranuar gjatë gjykimit, dhe (ii) është më mirë në gjendje të vlerësojë peshën dhe të vërë në balancë të gjitha dëshmitë që ka dëgjuar gjatë gjykimit – në fund të procesit gjyqësor. Shih Aktgjykimin e Apelit *Mustafa*, para. 38 dhe jurisprudencën e cituar në të.

<sup>197</sup> Shih më lart, para. 65.

<sup>198</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 218.

kujdes i veçantë nga ana e Trupit Gjykses kur të vendosë se çfarë peshe do t'u japë, nëse do t'u japë peshë, deklaratave të tilla".<sup>199</sup>

72. Sido që të jetë, Paneli rikujton se deklaratat e një të bashkakuzuari (ose dëshmitari), të cilit Mbrojtja nuk ka pasur mundësi t'i bëjë pyetje, nuk mund të përdoren për të mbështetur një vendim fajësie kundër të akuzuarit.<sup>200</sup> Siç ka vënë në dukje edhe Trupi Gjykses, GJEDNJ-ja është shprehur se një vendim fajësie i bazuar vetëm ose në një masë vendimtare në prova të të akuzuarit ose bashkakuzuarit, të cilit i akuzuari nuk ka pasur mundësi t'i bëjë pyetje, është në mospërputhje me nenin 6 të KEDNJ-së.<sup>201</sup> Kjo garanci mbrojtëse është përfshirë edhe në kornizën ligjore të Dhomave të Specializuara në rregullën 140(4)(a) të Rregullores, ku thuhet se shpallja e fajësisë nuk mund të bazohet vetëm, ose në një masë vendimtare në deklaratën e një dëshmitari, të cilin Mbrojtja nuk ka pasur mundësi ta pyesë. Rrjedhimisht, Paneli gjykon se ekzistojnë garanci mbrojtëse të mjaftueshme sipas të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe kornizës ligjore të vetë Dhomave të Specializuara<sup>202</sup> për të mbrojtur të drejtat e të akuzuarit në lidhje me përdorimin e deklaratave të të bashkakuzuarve kundër të akuzuarit në këtë çështje gjyqësore.

73. Bazuar në sa më lart, Paneli i Apelit konstaton se Trupi Gjykses nuk gaboi në vendimin për pranimin dhe përdorimin e deklaratave të të bashkakuzuarve në lidhje me të akuzuarit e tjerë në këtë fazë të procesit dhe, rrjedhimisht, rrëzon Pikën e Nëntë të Krasniqit.

---

<sup>199</sup> Vendimi i Kundërshtuar, para. 218.

<sup>200</sup> Shih më lart, para. 67. Shih gjithashtu p.sh. ICTY, *Prosecutor v. Popović et al.*, IT-05-88-T, Decision on the Admissibility of the Borovčanin Interview and the Amendment of the Rule 65 *ter* Exhibit List, 25 October 2007, paras 77-80.

<sup>201</sup> Shih *Lucà* Judgment, paras 39-45; *Al-Khawaja and Tahery* Judgment, paras 126-147. Shih gjithashtu Vendimin e Kundërshtuar, para. 218.

<sup>202</sup> Shih gjithashtu nenin 3(2)(e) të Ligjit.

## V. VENDIM

74. Për arsyet e lartpërmendura, Paneli i Gjykatës së Apelit:

**RRËZON** Apelet;

**URDHËRON** riklasifikimin e Përgjigjes Përmbledhëse të ZPS-së dhe Kundërpërgjigjes së Krasniqit sipas rregullës 82(5) të Rregullores;

**URDHËRON** Krasniqin të dorëzojë versionin e redaktuar publik të Apelit të Krasniqit ose të bëjë të ditur me anë të një parashtrimi nëse ai mund të riklasifikohet si publik, brenda dhjetë ditësh nga marrja e njoftimit për këtë vendim; dhe

**UDHËZON** Zyrën Administrative të bëjë riklasifikimin e Apelit të Krasniqit, pasi Krasniqi të informojë, nëse do të informojë, se ai mund të riklasifikohet.

/nënshkrimi/

**Gjykatëse Mishelë Pikar,**  
**Kryegjykatëse**

E premte, 31 maj 2024

Në Hagë, Holandë.